



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Bioteknologji
Molekulare dhe Industriale”**

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Egon Andoni

Prof.Asoc. Sonila Çoçoli

Nëntor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” ofruar nga Universiteti
i Tiranës


1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Bioteknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008 UMAS Nr. 615, datë 26.12.2024 për miratimin e ofrimit në gjuhën angleze.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 171, datë 13.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite dhe 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip / Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 16 PAE / 4 PAK 2022-2023 15 PAE / 4 PAK 2023-2024 15 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 32 studentë 2022-2023 30 studentë 2023-2024 26 studentë 2024-2025 38 studentë
19	Komente / të tjera:	UMAS Nr. 615, datë 26.12.2024 për miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze të këtij programi studimi. Veprimtaria akademike e këtij urdhëri, fillon sipas legjislacionit në fuqi.




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përbën një nga njësitë akademike kryesore të Universitetit të Tiranës. Ky Universitet është themeluar në vitin 1957 dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga tetë departamente. Veprimtaria e këtij institucioni zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës. Zbatimi i këtyre akteve siguron funksionimin e rregullt institucional, autonominë akademike dhe përputhjen me standardet kombëtare të cilësisë në arsimin e lartë. Programi i studimeve Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është hapur për herë të parë në vitin 2008, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1225, datë 03.09.2008 dhe UMAS Nr. 615, datë 26.12.2024 për miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze.. Qëllimi kryesor i programit të studimit është thellimi dhe zgjerimi i njohurive të fituara gjatë ciklit të parë (Bachelor), duke përgatitur specialistë të kualifikuar dhe të aftë për të aplikuar njohuritë shkencore në mënyrë profesionale dhe kërkimore brënda fushës së Bioteknologjisë. Programi synon të zhvillojë kompetenca të avancuara në biologjinë molekulare, teknologji bioproduktesh dhe menaxhim projektesh kërkimore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore shkencore. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe zgjat dy vite akademike, duke përfshirë një ngarkesë prej 120 kreditesh ECTS. Deri më sot, programi nuk ka kaluar një proces të plotë akreditimi që nga momenti i hapjes së tij. Ky proces është thelbësor për të siguruar një vlerësim të pavarur të cilësisë së programit dhe përputhshmërinë e tij me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Personeli akademik i Departamentit të Bioteknologjisë përbëhet nga 10 pedagogë, nga të cilët 7 mbajnë titujt “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, ndërsa 3 kanë titullin “Doktor i Shkencave”. Gjatë vitit akademik 2023-2024, numri i personelit akademik efektiv (PAE) është 10 lektorë. Përveç kësaj, programi mbështetet edhe nga personel akademik me kontratë (PAK), të cilët angazhohen sipas nevojave për mbulim mësimor ose ekspertizë të specializuar. Personeli akademik ka ruajtur stabilitet gjatë viteve të fundit dhe, përveç angazhimit në procesin e mësimdhënies, është aktiv edhe në projekte të ndryshme kërkimore-shkencore, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ky angazhim ka dhënë një ndihmesë reale në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, integrimin e kërkimit në procesin akademik dhe promovimin e ndërkombëtarizimit të institucionit. Njëkohësisht, ky departament zhvillon një bashkëpunim të ngushtë me një sërë institucionesh partnere në mbarë Europën, duke marrë pjesë si partner në projekte të ndryshme ndërkombëtare që fokusohen në fushën e kërkimit shkencor dhe rritjen e kapaciteteve humane.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përgjatë datave 5-6 Maj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i përbërë nga **Prof. Asoc Sonila Çoçoli** dhe **Prof. Asoc Egon Andoni**, në bashkërendim me koordinatorin teknik të ASCAL Msc. Arbri Ndreka, zhvilluan vizitën për vlerësimin e programit Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”. Hapi i parë i procesit të vlerësimit u bazua në një analizë të detajuar të dokumentacionit të ofruar nga programi Master. Kjo analizë shërbeu si themel për identifikimin paraprak të aspekteve për t’u verifikuar gjatë vizitës në terren dhe për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet përkatëse të cilësisë.

Gjatë vizitës në Departamentin e Bioteknologjisë gjatë ditës së parë, GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultit, Përgjegjësin e Departamentit, personelin akademik, GVB dhe studentët. Këto takime u realizuan me qëllim vlerësimin e funksionimit të programit, përfshirjes së stafit në veprimtari akademike dhe kërkimore, si dhe për të marrë feedback nga vetë studentët mbi përvojën e tyre studimore. Ditën e dytë GVJ realizoi një vizitë në ambientet laboratorike të Departamentit, Bibliotekën e Fakultetit dhe Sekretarinë Mësimore. Qëllimi i vizitës ishte të vlerësohej infrastruktura mbështetëse për procesin mësimor dhe kërkimor, si dhe organizimi administrativ dhe aksesueshmëria e burimeve për studentët dhe stafin. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u fokusua në vlerësimin e përmbushjes së gjashtë standardeve kryesore, në përputhje me kriteret përkatëse të cilësisë në arsimin e lartë. Raporti përfundimtar ofron një analizë përmbledhëse të programit Master, duke evidentuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm institucional.

Ekspertët realizuan verifikimin e të dhënave për të siguruar një vlerësim sa më objektiv në lidhje me procesin e rekrutimit të stafit akademik dhe funksionimin e sekretarisë mësimore. Ky verifikim kishte për qëllim të vlerësonte përputhshmërinë e procedurave me kuadrin rregullator dhe standardet e cilësisë në administrimin akademik. Qëllimi i raportit është të ndihmojë institucionin në forcimin e kapaciteteve akademike dhe administrative, përmes rekomandimeve të mbështetura në gjetjet e vlerësimit.

Si përfundim duam të falenderojmë për bashkëpunimin e ngushtë Drejtuesen e Departamentit, personelin akademik, ndihmës akademik dhe strukturat përkatëse të Institucionit, të cilat na mundësuan sigurimin e dokumentacionit shtesë të nevojshëm gjatë vizitës sonë dy ditore. Ky informacion i detajuar dha një ndihmesë reale në përpilimin e një raporti sa më të plotë dhe objektiv.



Më datë 29.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.162/31 Prot., datë 29.10.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 07.11.2025 dhe me shkresë zyrtare, datë 05.11.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin:

GVJ, pasi u njoh me komentet e IAL-së, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

1. Standardi II.3 - Kriteri 5

Në RVB janë të pranishme të dhëna që tregojnë nisma bashkëpunimi dhe komunikimi me alumni dhe punëdhënësit. Megjithatë, ato paraqiten të shpërndara në disa standarde/nën-kritere dhe ende nuk përbëjnë një mekanizëm të unifikuar dhe të formalizuar për grumbullimin sistematik, analizimin dhe përdorimin e feedback-ut për rishikimin periodik të programit. Prandaj, vlerësimi “Përmbushet kryesisht” mbetet i arsyetuar. **Raporti nuk ndryshon.**

2. Standardi III.5 - Kriteri 7

Procesi i diplomimit dhe pajisjes me dokumentacion zyrtar funksionon në mënyrë korrekte. Megjithatë, ndjekja e mëtejshme e karrierës së të diplomuarve dhe integrimi i këtyre të dhënave në përmirësimin e programit nuk është i dokumentuar në formën e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi. Për këtë arsye, vlerësimi “Përmbushet kryesisht” konsiderohet i drejtë. **Raporti nuk ndryshon.**

3. Standardi IV.4 - Kriteri 6


Janë identifikuar bashkëpunime dhe njoftime të publikuara në platforma zyrtare dhe rrjete sociale, të cilat tregojnë angazhim aktiv të departamentit. Megjithatë, nuk ekziston ende një regjistër i strukturuar dhe i përditësuar i marrëveshjeve me sektorin privat të lidhura specifikisht me programin, me përcaktim të qartë të rezultateve dhe detyrimeve për secilin partner. Prandaj, vlerësimi “Përmbushet kryesisht” pasqyron realisht situatën aktuale. **Raporti nuk ndryshon.**




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është i përshtatur me objektivat dhe misionin e Universitetit të Tiranës (UT), duke u mbështetur në kapacitetet akademike dhe kërkimore të Departamentit të Bioteknologjisë dhe duke iu përmbajtur udhëzimeve dhe miratimeve institucionale. Statuti i Universitetit dhe Strategjia e Zhvillimit 2023–2028 e vendosin institucionin në qendër të arsimit cilësor dhe kërkimit shkencor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kombëtar. Programi integron elementë kërkimorë dhe teknologjikë në fushën e bioteknologjisë, duke u harmonizuar me prioritetet kombëtare për avancimin e shkencës dhe inovacionit. Programi është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me VKM nr. 1225, datë 03.09.2008 dhe përfaqëson një hap konkret në zhvillimin e kapaciteteve akademike të departamentit, duke kontribuar në formimin e specialistëve të nevojshëm në një fushë strategjike për vendin. Duke u bazuar në evidencat e paraqitura dhe në informacionin e marrë gjatë procesit të vlerësimit, programi është në përputhje të mirë me misionin institucional dhe prioritetet strategjike kombëtare dhe institucionale. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 1.2 – Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.3 – Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1225, datë 03.09.2008, për miratimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe	Struktura ligjore dhe organizative e Universitetit të Tiranës ofron bazën për zhvillimin e programeve të studimit në përputhje me misionin institucional dhe fushat përkatëse të veprimtarisë. Sipas





misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Statutit të UT, Neni 8, pika 6, institucioni ka të drejtë të hartojë programe dhe projekte të veçanta arsimore dhe kërkimore, të orientuara nga nevojat e fushave përkatëse dhe të angazhohet në konkurrime për financime në nivel kombëtar e ndërkombëtar, në fushat e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor. Kjo dispozitë ligjore dëshmon se UT ka fleksibilitetin për të zhvilluar programe studimi në harmoni me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe kapacitetin për të reaguar ndaj nevojave të tregut dhe zhvillimit akademik. Universiteti përbëhet nga gjashtë fakultete, dy institute, një filial dhe një departament ndërfaqultetor, të cilat veprojnë si njësi zbatuese për zhvillimin dhe implementimin e programeve të studimit, duke reflektuar organizimin e brendshëm të UT-së dhe shtrirjen e tij funksionale. Në këtë kuadër, vlerësohet se UT ka një kornizë të qartë rregullatore dhe strukturore që siguron zhvillimin e programeve në përputhje me misionin dhe me fushat e përcaktuara të veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 8, pika 6, fq. 5</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullore e Universitetit të Tiranës që përcakton strukturën organizative dhe funksionimin e njësive akademike (fakultete, institute, filiale, departamente ndërfaqultetore)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, është konceptuar dhe ofruar në përputhje të plotë me dokumentet themelore të Universitetit të Tiranës, duke respektuar qartë orientimet strategjike, misionin dhe fushat akademike të institucionit. Sipas Statutit të UT, universiteti ka për detyrë të hartojë programe studimi dhe projekte të veçanta që lidhen ngushtësisht me misionin e tij akademik dhe kërkimor. Po ashtu, <i>neni 11 dhe 14 i Statutit</i> përcaktojnë rolin thelbësor të departamenteve në zhvillimin e përmbajtjes akademike dhe në përshtatjen e saj me zhvillimet shkencore dhe tregun e punës. Në të njëjtën linjë, <i>Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028</i> përcakton qartë synimin për forcimin e lidhjes së programeve të studimit me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Objektivat e kësaj strategjie (<i>Pika 4, fq. 13</i>) përfshijnë ndër të tjera rritjen e angazhimit me sektorin privat, promovimin e sipërmarrjes dhe lehtësimin e transferimit të njohurive në funksion të nevojave të tregut.




	Programi reflekton këto qëllime përmes integritetit të përmbajtjeve shkencore dhe praktike në fushat prioritare të bioteknologjisë, si industria ushqimore, farmaceutikë, mjedisi dhe mbrojtja e shëndetit publik - fusha që lidhen ngushtë me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Gjithashtu, Departamenti i Bioteknologjisë ka hartuar Strategjinë e tij të Zhvillimit 2023-2028, si dhe Strategjinë e Zhvillimit të Programit MSH në BMI, të cilat theksojnë qartë përkushtimin ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Rregullorja e përgjithshme e UT dhe ajo e FSHN (Neni 35 dhe 36) saktësojnë më tej strukturën dhe përgjegjësitë për hartimin dhe menaxhimin e programeve të studimit, duke e vendosur programin në një kuadër të mirëorganizuar institucional. Bazuar në evidencat e sipërcituara, vlerësohet se programi është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë zhvillimore të institucionit, Statutin, Rregulloren dhe drejtimit akademike të Universitetit të Tiranës. <i>Evidenca 0.1 – Mendimi i Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për përputhshmërinë e programit me strategjinë institucionale</i> <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, Nenet 8, 11 dhe 14</i> <i>Evidenca 1.2 – Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës 2023–2028, Pika 4, fq. 13</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullore e Universitetit të Tiranës dhe e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Nenet 35 dhe 36</i> <i>Evidenca 1.5 – Strategjia e Zhvillimit e Departamentit të Bioteknologjisë 2023–2028</i> <i>Evidenca 1.5.1 – Strategjia e Zhvillimit e Programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe dokumentet orientuese kombëtare dhe ndërkombëtare që përcaktojnë fushat prioritare të arsimit, kërkimit dhe inovacionit në Shqipëri. Ky program reflekton në përmbajtjen e tij drejtimit strategjike të përcaktuara në: • Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 (Evidenca 1.6),

vendas dhe atë ndërkombëtar.	• Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (<i>Evidenca 1.7</i>), • Strategjinë e Arsimit 2021–2026 (<i>Evidenca 1.8</i>), • Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2023 (<i>Evidenca 1.9</i>). Gjithashtu, programi bazohet në një analizë të qartë të kontekstit kombëtar të tregut të punës dhe nevojave zhvillimore, të mbështetura në dokumente të rëndësishme analitike dhe statistikore si: • Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021 (<i>Evidenca 1.10</i>), • Regjistri i Biznesit i INSTAT 2021 (<i>Evidenca 1.11</i>), • Anketa Tremujore e Forcave të Punës - T3, 2021 (<i>Evidenca 1.13</i>), • Raporti i Tregut të Punës në Shqipëri, 2017 (<i>Evidenca 1.14</i>), • Të dhënat e INSTAT mbi strukturën e tregut të punës, 2021 (<i>Evidenca 1.15</i>). Të gjitha evidencat mbështesin faktin se fusha e bioteknologjisë ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik, kërkimin shkencor dhe inovacionin, si dhe për integrimin e tregut të punës shqiptar në standardet evropiane. Në këtë mënyrë, programi MSH në BMI është konceptuar si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj prioritetëve kombëtarë dhe globale, duke ndihmuar në përgatitjen e kuadrove të kualifikuar dhe në forcimin e lidhjes mes arsimit të lartë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit.			
Konkluzione	<i>Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është hartuar dhe ofruar në përputhje të plotë me misionin, statutin dhe strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës, duke reflektuar qartë prioritetet institucionale dhe kombëtare në fushën e arsimit, kërkimit dhe inovacionit. Programi mbështetet në dokumentacion të plotë ligjor e strategjik dhe adreson nevojat e tregut të punës në sektorë kyç si industria ushqimore, farmaceutikë dhe mbrojtja e mjedisit e shëndetit publik. GVJ vlerëson se programi përmbush plotësisht standardin në lidhje me përputhshmërinë me misionin institucional, strategjitë zhvillimore dhe dokumentet rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Tiranës disponon infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, me një sipërfaqe trualli prej 190,597 m² dhe godina me një sipërfaqe totale prej 19,835 m², që siguron kushte optimale për zhvillimin e programeve. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), ku vepron Departamenti i Bioteknologjisë, është një nga njësitë më të mëdha të UT, me 8 departamente dhe një qendër kërkimore. Departamenti i Bioteknologjisë ka staf akademik të kualifikuar, me 10 anëtarë (3 profesorë doktorë, 4 profesorë asistentë, 3 doktorë) dhe 5 ndihmës akademikë. Laboratorët dhe ambientet e mësimdhënies janë të pajisura mirë dhe përmbushin nevojat e praktikave dhe kërkimit shkencor. Përveç stafit akademik, departamenti mbështetet nga personel ndihmës akademik dhe administrativ, që siguron funksionimin e suksesshëm të programeve. Në këtë mënyrë, Universiteti i Tiranës posedon kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” me cilësi të lartë akademike dhe në përputhje me kërkesat e fushës. <i>Evidenca 1.2 – Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës, që përfshin të dhënat mbi infrastrukturën dhe sipërfaqet në përdorim</i> <i>Evidenca 1.16 – Tabela ASCAL 16: Mjediset e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), UT</i> <i>Evidenca 1.17 – Struktura organizative e FSHN dhe qendra kërkimore në përbërje</i> <i>Evidenca 1.18 – Lista e stafit akademik të Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 1.19 – Inventarët e laboratorëve dhe pajisjeve në Departamentin e Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 1.20 – Lista e personelit ndihmës akademik dhe administrativ të Departamentit të Bioteknologjisë</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet	Programi i MSH-së në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, i ofruar nga Departamenti i Bioteknologjisë, menaxhohet në nivel fakulteti dhe realizohet në bashkëpunim me të gjitha njësitë bazë të

të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	tij. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, FSHN, siç reflektohet në misionin dhe qëllimet e saj. Kjo përputhje është dokumentuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, ku programet klasifikohen dhe kodifikohen sipas legjislacionit kombëtar dhe udhëzimeve europiane (<i>Lista e programeve të studimit të kodifikuara / Ligji për IAL nr. 80/2015</i>). Në këtë mënyrë, programi i studimit është i përputhshëm me kërkesat institucionale dhe standardet kombëtare dhe europiane për fushat akademike dhe kërkimore përkatëse. <i>Evidenca 1.4 – Rregullore e Universitetit të Tiranës, që përcakton klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit kombëtar dhe udhëzimeve europiane</i> <i>Evidenca 1.1 – Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (në përputhje me përcaktimet për fushat akademike dhe kërkimore të programeve të studimit)</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master i Shkencave (MSH) në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është strukturuar dhe organizuar në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e UT dhe Rregulloren specifike të programit të studimit. Plani mësimor i programit është hartuar sipas kërkesave të Statutit të UT (<i>Kreu VII, Nenet 87-90</i>) dhe përputhet me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me Ligjin Nr. 10 247, datë 04/03/2010. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, Departamentit të Bioteknologjisë. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, kjo përputhje sigurohet edhe nga njësitë bashkëpunuese akademike, në përputhje me kërkesat e udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, Nenet 87–90 (Kreu VII), që përcaktojnë strukturën dhe organizimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Nenet 13, 36, 38, 39 dhe 43, që rregullojnë organizimin akademik dhe administrativ të programeve të studimit, si dhe Neni 81 për mbrojtjen e diplomës</i> <i>Evidenca 1.21 – Rregullore specifike e programit të studimit MSH</i>




	<i>në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", për vitet akademike 2021–2024</i> <i>Evidenca ligjore shitesë – Ligji Nr. 10 247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" (niveli 7 i KSHK-së)</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet në rastin e Programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Veprimtaria e Universitetit të Tiranës (UT) organizohet dhe funksionon në përputhje me Statutin dhe rregulloret e brendshme, përmes njësive përbërëse dhe strukturave drejtuese e administrative në të gjitha njësitë kryesore dhe në Rektorat. Programi MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" zbatohet në bashkëpunim ndërmjet Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me staf akademik të dokumentuar dhe të angazhuar nga departamentet përkatëse të UT. Koordinimi i ngarkesës mësimore dhe orareve bëhet nga dekanati dhe njësiti bazë, sipas procedurave të miratimit të kuotave dhe kriterëve të pranimit. Përveç ofrimit të programeve akademike, UT ka krijuar mekanizma për ofrimin e trajnimeve profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar, në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit dhe aktorët e tregut të punës. Ky bashkëpunim realizohet përmes: • Marrëveshjeve institucionale me sektorin privat dhe publik; • Praktikave profesionale dhe mentorimit të vazhdueshëm; • Organizimit të kurseve të avancuara dhe trajnimeve me fokus në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu; • Forumesh dhe grupe pune të përbashkëta për përcaktimin e nevojave profesionale dhe përshtatjen e kurrikulave. Departamenti i Bioteknologjisë ndjek dhe koordinon vazhdimisht ngarkesën mësimore dhe cilësinë e mësimdhënies, duke komunikuar me dekanatin për veprimtaritë akademike dhe kërkimore. Të dhënat dhe rezultatet pasqyrohen në raportet vjetore të departamentit dhe njësisë kryesore, të cilat i transmetohen Rektoratit për përpilimin e raportit institucional.

	Mekanizmat për trajnime profesionale për të diplomuarit në bashkëpunim me punëdhënësit janë një praktikë e rëndësishme që përforcon lidhjen ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës, duke rritur punësueshmërinë dhe adaptueshmërinë profesionale të të diplomuarëve. Bashkëpunimi institucional, dokumentuar me marrëveshje dhe aktivitete të përbashkëta, është në linjë me standardet e cilësisë. <i>Rekomandohet formalizimi i mëtejshëm i këtij procesi përmes një sistemi të integruar vlerësimi dhe përshtatjeje të vazhdueshme të programeve dhe trajnimeve bazuar në feedback-un e punëdhënësve dhe ish-studentëve.</i> <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 89, fq. 50 (organizimi dhe funksionimi i veprimtarisë së UT në përputhje me strukturat drejtuese dhe administrative)</i> <i>Evidenca 1.24 – Lista e stafit akademik të angazhuar në programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 1.25 – Orari dhe ndarja e ngarkesës mësimore për programin MSH në BMI</i> <i>Evidenca 1.26 – Vendime të dekanatit për miratimin e ngarkesës mësimore dhe koordinimin ndërfakultetesh</i> <i>Evidenca 1.27 – Të dhëna mbi kujdestarët akademikë dhe mbështetjen për studentët në nivel departamenti</i> <i>Evidenca 1.28 – Raportet vjetore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore të Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT</i> <i>Evidenca 1.29 – Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për aktivitetet akademike dhe kërkimore</i>			
Konkluzione	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është në përputhje të plotë me fushën akademike të Departamentit të Bioteknologjisë, njësisë përgjegjëse për programin. Universiteti ofron infrastrukturë, laboratorë, staf akademik të kualifikuar dhe mbështetje administrative të mjaftueshme për realizimin e programit. Bashkëpunimi ndërmjet njësive akademike dhe me aktorë të jashtëm për praktika dhe trajnime profesionale përforcon komponentin praktik dhe zhvillimin profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3





Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ndërmjet njësive dhe personelit akademik e administrativ, përmes ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësisë përkatëse, si dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Në këtë kuadër, Programi i Masterit Shkencor në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” realizohet në bashkëpunim ndërmjet Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Stafi akademik i përfshirë përbëhet nga pedagogë të departamenteve të ndryshme të UT-së, të cilët koordinojnë ngarkesën mësimore, oraret dhe lëndët e programit. Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në bashkëpunim me njësitë bazë, koordinon ngarkesën e personelit dhe procesin mësimor, duke miratuar paraprakisht kuotat e pranimit, të cilat kalojnë për miratim në Senatin Akademik. Për zbatimin praktik të programit angazhohen gjithashtu kujdestarët akademikë. Departamenti i Bioteknologjisë ndjek analizën e vazhdueshme të procesit mësimor dhe komunikon me Dekanatin për koordinimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore. Rezultatet e kësaj analize pasqyrohen në raportet vjetore të njësive kryesore dhe të Departamentit të Bioteknologjisë, të cilat përmbledhen në raportin vjetor institucional të UT-së. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 89, fq. 56 (përshkruan ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë ndërmjet njësive akademike dhe administrative për hartimin e programeve të studimit)</i> <i>Evidenca 1.24 – Lista e stafit akademik të përfshirë në programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 1.25 – Orari dhe koordinimi i ngarkesës mësimore për programin MSH në BMI</i> <i>Evidenca 1.26 – Vendime dhe procedura të miratimit të kuotave të pranimit në nivel fakulteti dhe Senati Akademik</i> <i>Evidenca 1.27 – Emërimi i kujdestarëve akademikë për mbështetjen e studentëve gjatë ciklit të studimeve</i> <i>Evidenca 1.28 – Raportet vjetore të Departamentit të Bioteknologjisë mbi procesin mësimor dhe kërkimor</i>




	<i>Evidenca 1.29 – Raporti vjetor institucional i Universitetit të Tiranës, i cili përmbledh rezultatet e analizave të njësive kryesore dhe bazë</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti i Tiranës (UT) dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) sigurojnë realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve përmes marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, publike e private. UT ka nënshkruar 103 marrëveshje bilaterale aktive (2020–2023), 153 marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+ dhe 3 marrëveshje në kuadër të Programit Mevlana, duke vendosur partneritete me mbi 100 universitete homologe ndërkombëtare. Vetëm FSHN, në këtë kuadër, ka nënshkruar 97 marrëveshje bashkëpunimi për periudhën 2021–2025. Gjithashtu, Departamenti i Bioteknologjisë ka zhvilluar veprimtari të përbashkëta me institucione publike e private dhe organizma ndërkombëtare, duke lidhur procesin akademik me kërkimin shkencor dhe tregun e punës. <i>Evidenca 1.30 – Lista e marrëveshjeve ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës për periudhën 2020–2023</i> <i>Evidenca 1.31 – Marrëveshjet bilaterale të UT-së me universitete partnere ndërkombëtare</i> <i>Evidenca 1.32 – Marrëveshjet në kuadër të Programit Erasmus+</i> <i>Evidenca 1.33 – Marrëveshjet në kuadër të Programit Mevlana</i> <i>Evidenca 1.34 – Marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për periudhën 2021–2025</i> <i>Evidenca 1.35 – Marrëveshjet dhe aktivitetet e bashkëpunimit të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione publike, private dhe organizma ndërkombëtarë</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e	Për realizimin e programit të studimit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, Departamenti i Bioteknologjisë ka përfutur nga marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor të nënshkruara nga UT dhe FSHN me institucione kërkimore, kompani dhe organizma ndërkombëtarë, të cilat parashikojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe mobilitetin akademik. UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 103 universitete homologe jashtë vendit (2020–2023), ndërsa FSHN ka nënshkruar 97 marrëveshje bashkëpunimi për periudhën 2021–2025. Përmes këtyre marrëveshjeve, studentët e programit kryejnë praktika profesionale, përfshihen në veprimtari të përbashkëta kërkimore dhe mbështeten nga punëdhënësit për mbikëqyrjen e praktikave.



praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.	Në marrëveshjet e bashkëpunimit përcaktohen qartë detyrimet për realizimin e praktikave, mbikëqyrjen e tyre, si dhe angazhimi në publikime të përbashkëta shkencore. Një shembull konkret është mobiliteti i studentëve të programit pranë Universitetit të Perugias, Itali, në vitin akademik 2022–2023, në kuadër të Programit Erasmus+. <i>Evidenca 1.30 – Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor të Universitetit të Tiranës me institucione kërkimore, kompani dhe organizma ndërkombëtarë</i> <i>Evidenca 1.31 – Marrëveshje bilaterale ndërkombëtare të UT-së për periudhën 2020–2023</i> <i>Evidenca 1.32 – Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Programit Erasmus+</i> <i>Evidenca 1.33 – Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Programit Mevlana</i> <i>Evidenca 1.34 – Marrëveshjet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për periudhën 2021–2025 për zhvillimin e praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor</i> <i>Evidenca 1.35 – Marrëveshje të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione publike, private dhe organizma ndërkombëtarë për mbikëqyrjen e praktikave dhe bashkëpunimin shkencor</i> <i>Evidenca 1.36 – Dokumentacion mbi mobilitetin e studentëve të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” pranë Universitetit të Perugias, Itali, në kuadër të Programit Erasmus+ (2022–2023)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” harton raporte periodike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione, kompani dhe organizma ndërkombëtarë. Evidencat tregojnë se studentët dhe stafi angazhohen në projekte kërkimore, publikime shkencore, prezantime në konferenca, praktika profesionale dhe realizimin e tezave pranë institucioneve bashkëpunuese. Raportet analitike i përcillen Dekanatit dhe përfshihen në raportet vjetore të fakultetit, duke mundësuar një pasqyrim të qartë të ndikimit të bashkëpunimeve në cilësinë e programeve të studimit. Përfitimet nga këto marrëveshje evidentohen në aktivizimin e studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore, realizimin e detyrave dhe tezave të diplomës, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në publikime dhe konferenca shkencore. Kjo praktikë e raportimit periodik siguron gjithashtu një mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm të ndikimit të marrëveshjeve në




	procesin mësimor dhe formues, duke konfirmuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet bashkëpunimeve dhe përmirësimit të cilësisë së programit. <i>Evidenca 1.28 – Raportet vjetore të Departamentit të Bioteknologjisë mbi veprimtarinë akademike, kërkimore dhe bashkëpunimet institucionale</i> <i>Evidenca 1.37 – Raportet analitike të Departamentit të Bioteknologjisë për periudhën 2021–2024, që përfshijnë analizën e përfitimeve nga marrëveshjet dhe ndikimin në programet e studimit</i> <i>Evidenca 1.38 – Dokumentacion mbi pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në projekte kërkimore, publikime shkencore dhe konferenca ndërkombëtare</i> <i>Evidenca 1.39 – Raporte dhe dokumente që dëshmojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe realizimin e tezave të diplomës në bashkëpunim me institucionet partnere</i>			
Konkluzione	Departamenti i Bioteknologjisë dhe FSHN/UT kanë ngritur mekanizma të qartë dhe të dokumentuar për menaxhimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, përfshirë raportime periodike, monitorim të praktikave profesionale dhe angazhimin e studentëve dhe stafit në projekte kërkimore dhe publikime. Evidencat tregojnë se bashkëpunimet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit janë të zhvilluara dhe të zbatuara në mënyrë sistematike, duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e objektivave të programit dhe forcimin e komponentit praktik dhe kërkimor të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1




Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është strukturuar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, përfshirë Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si dhe me rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës. Programi përbëhet nga disiplina të qarta dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve për një vit akademik të plotë për studentët e ciklit të dytë “Master Shkencor” është 60 ECTS, ndërsa programi i plotë për dy vite akademike përmban 120 ECTS. Struktura e programit dhe veprimtaritë formuese janë të dokumentuara në planin mësimor, syllabuset e disiplinave, CV-të e personelit akademik dhe dokumente të tjera të detajuara të departamentit. Bazuar në këtë organizim dhe dokumentacion, programi i studimit përmbush plotësisht kriterin, duke reflektuar një strukturë të qartë akademike, përcaktim të sasisë së krediteve dhe përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane për programet e ciklit të dytë. <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e programit të studimit “Master i Shkencave në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani mësimor i programit për periudhën 2021–2024, me ndarjen e disiplinave dhe krediteve sipas sistemit ECTS</i> <i>Evidenca 2.1 – Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për miratimin e kriterëve të përgjithshme për hapjen, organizimin dhe funksionimin e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë”</i> <i>Evidenca 2.2 – Syllabuset e disiplinave të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.3 – CV-të e personelit akademik të angazhuar në program</i> <i>Evidenca 2.4 – Dokumentet mbështetëse mbi ngarkesën mësimore dhe shpërndarjen e krediteve për secilën lëndë</i> <i>Evidenca 2.5 – Tabela përmbledhëse e vlerësimit të krediteve sipas viteve akademike dhe moduleve përkatëse</i> <i>Evidenca 2.6 – Raportet e përputhshmërisë së strukturës së</i>


	<i>programit me Kornizën Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimeve (Niveli 7, 120 ECTS)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” synon formimin e specialistëve të fushës së bioteknologjisë, duke ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi profesionale në drejtimet e agrobioteknologjisë, bioteknologjisë farmaceutike, mjedisore dhe humane. Programi strukturohet në dy vite akademike, ku viti i parë përfshin disiplinat bazë dhe të avancuara në mikrobiologji, bioteknologji molekulare, kulturat qelizore dhe metodologji analitike, ndërsa viti i dytë fokusohet në disiplina të specializuara si Markerët Molekulare, Akuakultura, BioNanoTecnologjia, Bioenergjetika dhe Bioteknologjia e sistemeve ujore, të cilat zhvillojnë aftësi të larta për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e bioteknologjisë. Plani mësimor i programit pasqyron qartë raportin teori / seminare / laborator, numrin e krediteve për secilën disipilinë dhe detyrimet akademike për studentët. Nëpërmjet syllabuseve dhe seancave laboratorike/praktikave profesionale, studentët fitojnë aftësi eksperimentale, kërkimore dhe kompetenca të avancuara, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike dhe kërkimore në fushën e bioteknologjisë. Orët laboratorike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të programit, dhe mjediset e laboratorëve në departament dhe njësitë bashkëpunuese janë të pajisura dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive. Rregullorja e programit, qëllimet dhe objektivat janë të qarta dhe lidhin njohuritë teorike me aftësitë praktike, duke garantuar që studentët të pajisen me kompetenca të avancuara për punësim dhe zhvillim profesional në fushën e bioteknologjisë. <i>Evidenca 1.16 – Informacion i përgjithshëm mbi Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Departamentin e Bioteknologjisë, përfshirë strukturën organizative dhe kapacitetet laboratorike</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani mësimor i programit “Master i Shkencave në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” (2021–2024), me ndarjen e disiplinave, krediteve dhe orëve mësimore (teori, seminare, laborator)</i> <i>Evidenca 2.3 – CV-të e personelit akademik të angazhuar në disiplinat bazë dhe të avancuara të programit, me përshkrimin e eksperiencës kërkimore dhe mësimore në fushën e bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.3.1 – Syllabuset e lëndëve bazë dhe të specializuara të programit (mikrobiologji, kulturë qelizore, bioteknologji</i>



	<i>molekulare, bioenergjetikë, bionanoteknologji, akuakulturë etj.) Evidenca 1.34 – Marrëveshjet e bashkëpunimit të FSHN dhe Departamentit të Bioteknologjisë me institucione kërkimore, kompani dhe organizma ndërkombëtarë për zhvillimin e praktikave profesionale dhe punës laboratorike</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikave profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Format e mësimdhënies, aktivitetet laboratorike, praktikat profesionale dhe detyrimet përfundimtare janë të dokumentuara në rregulloren e programit, planin mësimor dhe syllabuset e disiplinave. Realizimi i praktikave profesionale për periudhën 2021–2024 është bërë sipas ngarkesës së përcaktuar në syllabuse dhe laboratorë, dhe plani mësimor i vitit akademik 2024-2025 përmban kategorinë e praktikës profesionale si një komponent të veçantë me kredite të qarta. Kjo strukturë garanton që studentët të fitojnë aftësi praktike dhe kompetenca profesionale të avancuara, në përputhje me objektivat e programit dhe kërkesat e fushës së bioteknologjisë. <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e programit të studimit “Master i Shkencave në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, ku përcaktohen format e mësimdhënies, detyrimet përfundimtare dhe mënyra e realizimit të praktikave profesionale</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani mësimor i programit për periudhën 2021–2024, me specifikimin e krediteve për praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave që përfshijnë komponentë praktikë dhe laboratorik, me përcaktimin e objektivave të kompetencave dhe metodologjisë së vlerësimit</i> <i>Evidenca 2.7 – Dokumentacion mbi realizimin e praktikave profesionale të studentëve në periudhën 2021–2024, përfshirë temat, institucionet pritëse dhe mbikëqyrësit akademikë</i> <i>Evidenca 2.8 – Plani mësimor i vitit akademik 2024–2025 me përfshirjen e “Praktikës Profesionale” si modul të pavarur dhe të vlerësuar me kredite ECTS</i> <i>Evidenca 2.9 – Raportet përfundimtare të praktikave profesionale dhe formularët e vlerësimit të studentëve, të dorëzuara nga njësitë bashkëpunuese dhe DSBCK</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit	Nuk aplikohet në rastin e Programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, FSHN, UT.




fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.



Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në verifikimin e kryer gjatë procesit të vlerësimit, konstatohet se programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është unik në nivel kombëtar, pasi nuk ofrohet nga institucione të tjera të arsimit të lartë me të njëjtën emërtesë dhe fushë specifike studimi. Programi paraqet një profil të qartë dhe të specializuar në fushën e bioteknologjisë molekulare dhe industriale, në përputhje me misionin akademik dhe kërkimor të Universitetit të Tiranës dhe me prioritetet kombëtare për zhvillimin e shkencës dhe inovacionit.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, është i kodifikuar sipas fushës së studimit dhe nivelit të kualifikimit, duke iu përmbajtur klasifikimeve zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (nivel 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve). Kodifikimi i disiplinave dhe i programit është kryer në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31, datë 15.11.2022, duke siguruar që identifikimi i programit dhe i lëndëve të tij të jetë i qartë, transparent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Evidenca 1.23: Kodifikimi i programit sipas fushës së studimit dhe nivelit të kualifikimit</i> <i>Evidenca 2.10: Udhëzimi i MAS Nr. 31, datë 15.11.2022, për kodifikimin e programeve të studimit dhe disiplinave</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.
Konkluzione	<i>Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është i organizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës dhe standardet evropiane për transferimin e krediteve (ECTS). Struktura e programit është e qartë, me disiplina dhe veprimtari formuese të dokumentuara, duke përfshirë orët teorike, seminarët, laboratorët dhe praktikat profesionale. Programi ofron njohuri të avancuara, aftësi dhe kompetenca të specializuara në fushën e bioteknologjisë, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe për</i>




	punësim profesional. Ngarkesa në kredite për realizimin e praktikave dhe detyrimeve përmbyllëse është e përcaktuar dhe e dokumentuar qartë. Kodifikimi i programit dhe i disiplinave është i saktë dhe në përputhje me klasifikimet zyrtare të Ministrisë së Arsimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																										
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Bioteknologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore) dhe rregulloret e brendshme të UT dhe FSHN. Struktura akademike dhe organizimi i stafit, përfshirë 10 pedagogë me tituj dhe grada të avancuara, si dhe grupet mësimore-kërkimore dhe laboratorët përkatës, janë të përshtatura për realizimin e programit dhe praktikave profesionale. Procesi i pranimit në program është i qartë dhe i bazuar në kriteret e përcaktuara për ciklin e dytë, ndërsa Universiteti i Tiranës ka akreditim institucional, duke siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe të detyrimeve ligjore. Për FSHN numri i personelit Akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, për 3 vitet e fundit akademike, është si më poshtë: <table><tr><th>Kualifikimi i stafit akademik të FSHN</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th></th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>34</td><td>12</td><td>37</td><td>10</td><td>40</td><td>7</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>39</td><td>8</td><td>41</td><td>7</td><td>41</td><td>8</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>69</td><td>22</td><td>78</td><td>16</td><td>74</td><td>17</td></tr><tr><td>Dr. proc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit akademik të FSHN	2021-2022		2022-2023		2023-2024			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	34	12	37	10	40	7	Prof. Asoc.	39	8	41	7	41	8	Dr/Phd	69	22	78	16	74	17	Dr. proc	-	-	-	-	-	-
Kualifikimi i stafit akademik të FSHN	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																						
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																					
Prof. Dr	34	12	37	10	40	7																																					
Prof. Asoc.	39	8	41	7	41	8																																					
Dr/Phd	69	22	78	16	74	17																																					
Dr. proc	-	-	-	-	-	-																																					



	Msc.	29	60	21	50	21	47
	Gjithsej	171	102	177	83	176	79

Stafi akademik i DB dhe kualifikimet e tyre për 3 vitet e fundit akademike, paraqiten si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të DB	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	2	1	3	-	3	-
Prof. Asoc.	4	1	4	1	4	1
Dr/Phd	4	-	3	1	3	1
Dr. proc	-	-	-	-	-	-
Msc.	-	2	-	2	-	1
Gjithsej	10	4	10	4	10	3

Aneks tabelat permbledhese RVB Tabelat 1.1, 1.2, 1.3; 2.1, 2.2, 2.3;



Departamenti i Bioteknologjisë përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për njësinë bazë përgjegjëse për programin, duke garantuar strukturë akademike të qartë, staf kompetent dhe kapacitete laboratorike adekuate për realizimin e programit MSH.

Evidenca 1.4: Rregullorja e Universitetit të Tiranës
Evidenca 2.7: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
Evidenca 1.18: Struktura dhe përbërja akademike e Departamentit të Bioteknologjisë
Evidenca 2.5: Laboratorët dhe grupet kërkimore të Departamentit të Bioteknologjisë
Evidenca 1.21: Rregullorja e programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”
Evidenca 1.26: Kriteret e pranimit në programin e ciklit të dytë
Evidenca 2.11: Raporti i Akreditimit Institucional të UT
Evidenca 2.12: Vendimi për Akreditimin e Universitetit të Tiranës

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Departamenti i Bioteknologjisë, njësia kryesore përgjegjëse për programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, ka angazhuar 5 anëtarë të stafit ndihmës-akademik/administrativ
--	--




përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	(Evidenca 1.24: Tabela 2 ASCAL), të gjithë të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve (Master i Shkencave), tre prej të cilëve janë pjesë e departamentit. Stafi ndihmës-akademik mbështet realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale, asistencën e studentëve gjatë përgatitjes së tezave të diplomës dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike. Përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara në rregulloren e departamentit për laboratorët dhe dokumentacionin e programit (Evidenca 2.15), duke garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore për organizimin e veprimtarive mësimore dhe laboratorike. <i>Evidenca 1.24: Tabela 2 ASCAL – Stafi ndihmës-akademik dhe administrativ i Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.15: Rregullorja e departamentit për funksionimin e laboratorëve dhe menaxhimin e dokumentacionit të programit</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Bioteknologjisë ka caktuar Përgjegjësin e Departamentit si koordinator të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë e programit, duke përfshirë miratimin e kuotave, sensibilizimin e nxënësve të shkollave të mesme për të ndjekur programin, organizimin e mësimdhënies, ndjekjen e përmbushjes së objektivave të programit, si dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me institucione bashkëpunuese publike dhe private për realizimin e praktikave profesionale. <i>Sipas Neneve 23 dhe 24 të Rregullores së UT, Përgjegjësi i Departamentit/Koordinatori monitoron programet e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore, duke ruajtur dokumentacionin e aktivitetit akademik dhe shkencor. Brenda departamentit funksionojnë dy grupe mësimore-kërkimore: (I) Bioteknologjia Molekulare, drejtues Prof. Dr. A.B., dhe (II) Bioteknologjia Industriale, drejtues Prof. Dr. K. P.. Koordinatori mbikëqyr gjithashtu angazhimin e stafit më të ri akademik, stafit ndihmës-akademik dhe ish-studentëve të diplomuar në realizimin e mësimdhënies, tezave të diplomës dhe praktikave profesionale pranë institucioneve bashkëpunuese, duke vënë theks të veçantë në mundësitë për punësim të studentëve.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 1.34: Marrëveshje me institucione dhe organizata bashkëpunuese për zhvillimin e praktikave profesionale</i>





Konkluzione	Njësia kryesore përgjegjëse për programin MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" - Departamenti i Bioteknologjisë - përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. Struktura akademike, stafi kompetent akademik dhe ndihmës, organizimi i laboratorëve dhe koordinimi i programit sigurojnë realizimin efektiv të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij, duke garantuar gjithashtu mbështetje për punësim të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT, në përputhje me rregulloret e UT dhe të vetë departamentit, ka siguruar informacion të plotë dhe të detajuar mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale". Dokumentacioni i depozituar, duke përfshirë planin mësimor dhe programin e ciklit të dytë, pasqyron qartë ndarjen e disiplinave në lëndë bazë, ndërdisiplinore dhe plotësuese, si dhe detyrimet përmbyllëse për përgatitjen e tezës së diplomës. Ky nivel i detajimit garanton qartësi për studentët dhe mbështet realizimin efektiv të objektivave formuese të programit të ciklit të dytë. <i>Evidenca 1.4 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës dhe e Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i> <i>Evidenca 2.7 – Rregullorja e Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e Programit MSH "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Programit të Studimit 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.2 – Programi i ciklit të dytë për Bioteknologji Molekulare dhe Industriale</i> <i>Evidenca 2.2.1 – Përshkrimi zyrtar i programit të ciklit të dytë (Master i Shkencave)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet	Programi i studimit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" është hartuar dhe strukturuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, për elementët e programeve të studimit të





informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. Planifikimi i programit është i detajuar, duke përfshirë ndarjen e lëndëve në vite dhe semestra, ngarkesën mësimore në kredite dhe orë, si në auditor ashtu edhe jashtë tij (praktika), duke siguruar qartësi për studentët mbi kërkesat akademike. Programi përmban gjithsej 120 ECTS në 2 vite akademike (4 semestra), me 60 ECTS për çdo vit, duke përfshirë syllabuset dhe planin mësimor të detajuar të disiplinave. Ky nivel organizimi garanton zbatimin efektiv të objektivave të programit dhe mundësinë për zhvillimin e kompetencave teorike dhe praktike të studentëve. <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Programit të Studimit (me ndarjen e lëndëve në vite dhe semestra)</i> <i>Evidenca 2.2.1 – Plani semestral i programit për 120 ECTS / 4 semestra</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.3.1 – Tabela përmbledhëse e ngarkesës orare për disiplinë (leksione, seminare, laboratorë)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” përmban informacion të plotë dhe të qartë për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, ripranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky informacion është i bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 (nenet 74 dhe 89), VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si dhe udhëzimet përkatëse të MASR dhe rregulloret e UT dhe FSHN). Menaxhimi i kuotave të lira dhe informimi i studentëve realizohet në përputhje me procedurat zyrtare dhe shpallet për publikun, duke siguruar transparencë dhe qartësi për proceset akademike dhe administrative. <i>Evidenca 1.26 – Kriteret e pranimit të studentëve në Programin MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.16 – Procedura e transferimit të studimeve ndërmjet programeve të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca 2.17 – Procedura e ekuivalentimit të lëndëve dhe krediteve</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës dhe FSHN për pranime, transferime dhe ripranime</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme	Programi i studimit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” ofron informacion të plotë dhe të detajuar për studentët lidhur me kriteret e pranimit, ripranimit, transferimit dhe




për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi janë të përcaktuara në <i>Evidencën 1.26 (Kriteret e pranimi të studentëve në Programin MSH)</i>, ndërsa procedurat për transferim janë të dokumentuara në <i>Evidencën 2.16 (Procedura e transferimit të studimeve)</i>, dhe ekuivalentimi i lëndëve dhe krediteve është i mbuluar nga <i>Evidenca 2.17 (Procedura e ekuivalentimit)</i>. Menaxhimi i kuotave të lira dhe regjistrimet e studentëve kryhen sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 të MASR, dhe rregulloret e UT dhe FSHN (<i>Evidenca 1.4: Rregullore e UT</i>), duke siguruar që studentët të kenë informacion të qartë dhe të azhurnuar mbi proceset akademike dhe administrative. Informimi i studentëve realizohet edhe përmes publikimeve në faqen zyrtare të fakultetit (www.fshn.edu.al). <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave (qëllimet, rezultatet e të nxënit, formatet e vlerësimit)</i> <i>Evidenca 2.3.1 – Ngarkesa orare për komponentët teorikë, seminare dhe laboratorë</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor me kategorizimin e lëndëve bazë, të avancuara dhe praktike</i> <i>Evidenca 1.34 – Dokumente mbi marrëveshjet e praktikave profesionale dhe përfshirjen e studentëve në laboratorë kërkimorë</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Departamenti i Bioteknologjisë synon që programi i studimit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” të sigurojë formimin e një grupi specialistësh me kompetenca shkencore dhe profesionale të përshtatshme për tregun e punës dhe për vijimin e studimeve të doktoraturës. Përmbajtja e programit përditësohet në mënyrë të vazhdueshme për të reflektuar zhvillimet e reja në fushën e bioteknologjisë dhe nevojat e tregut. Në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, janë rishikuar kategorizimet e disiplinave dhe është përditësuar plani mësimor për vitet akademike 2020–2021 dhe 2024–2025. Procesi i rishikimit realizohet në bashkëpunim me strukturat e fakultetit dhe miratohet nga Këshilli i Fakultetit dhe Rektorati. Dosja e programit është përgatitur dhe arkivuar në gjuhën shqipe dhe angleze, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë aktorët institucionalë. <i>Megjithatë, konstatohet mungesa e një mekanizmi të integruar dhe sistematik për mbledhjen dhe analizimin e feedback-ut nga punëdhënësit dhe ish-studentët (alumni), gjë që kufizon aftësinë e</i>




	<i>programit për të reflektuar në mënyrë dinamike kërkesat e tregut të punës dhe përmirësimet e kurrikulës në bazë të evidencave empirike.</i> <i>Megjithëse procesi formal i rishikimit dokumentohet rregullisht, mungon një mekanizëm i strukturuar për përfshirjen e aktorëve të jashtëm (punëdhënës dhe alumni) në analizën e përmirësimit të programit.</i> <i>Kjo tregon se, ndonëse procesi formal i rishikimit kryhet rregullisht dhe dokumentohet, duhet të forcohet dimensionin e përfshirjes së aktorëve të jashtëm në procesin e vlerësimit dhe përditësimit të përmbajtjes së programit.</i> <i>Evidenca 1.8 - Plani Mësimor 2020–2021 (rishikuar sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018)</i> <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Programit të Studimit MSH "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" (2024–2025)</i> <i>Evidenca 2.18 – Dosja e Programit në gjuhën angleze (miratuar për vitin akademik 2024–2025)</i> <i>Evidenca 2.9 – Dosja e plotë e Programit (në gjuhën shqipe dhe angleze), e arkivuar nga Departamenti i Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.26 – Njoftimi vjetor i stafit për përditësimin e syllabuseve dhe materialeve mësimore</i> <i>Evidenca 2.32 – Procedura për miratimin e ndryshimeve në planin mësimor (Departament – Dekanat – Rektorat)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka një bazë të fortë akademike dhe përmbajtja e tij është ndërtuar në përputhje me standardet bashkëkohore dhe zhvillimet shkencore të fushës së bioteknologjisë. Struktura e programit, shpërndarja e lëndëve teorike dhe komponentëve praktikë janë të balancuara dhe sigurojnë formimin e kompetencave të përshtatshme për nivelin e ciklit të dytë të studimeve.</i> <i>Megjithatë, konstatohet mungesa e një mekanizmi të integruar dhe sistematik për mbledhjen dhe analizimin e feedback-ut nga punëdhënësit dhe ish-studentët (alumni), gjë që kufizon aftësinë e programit për të reflektuar në mënyrë dinamike kërkesat e tregut të punës dhe përmirësimet e vazhdueshme të kurrikulës.</i> <i>Standardi përmbushet kryesisht, pasi programi ka strukturë të mirë, përmbajtje bashkëkohore dhe përputhje me standardet akademike, por kërkon forcimin e mekanizmave të përfshirjes së aktorëve të jashtëm në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




			X	
--	--	--	---	--


Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është i strukturuar në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Emërtimi dhe përmbajtja e disiplineve ofrojnë mundësi për thellim të njohurive dhe zhvillim të aftësive në fushat e bioteknologjisë, duke përfshirë mikroorganizma, bimë, kafshë dhe aplikime humane. Kjo strukturë lejon jo vetëm vijimin e studimeve të mëtejshme, por edhe punësimin e drejtpërdrejtë në sektorë prioritarë të ekonomisë vendore, si industria ushqimore, farmaceutika, mjekësia, bujqësia dhe mbrojtja mjedisore. Orët laboratorike dhe praktikat profesionale përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të programit dhe realizohen sipas planeve mësimore të miratuara, duke mundësuar përvetësim praktik të kompetencave teorike dhe profesionale. Përveç kësaj, programi përmban syllabuset dhe planin mësimor të detajuar për çdo disiplinë, duke përfshirë orët në auditor dhe jashtë tij, në përputhje me standardet për ECTS. Bazuar në raportet e ndjekjes së studentëve pas diplomimit, shumica e tyre janë të punësuar në institucione publike dhe private që lidhen me profilin e programit, përfshirë ndërmarrje farmaceutike, kompani të marketingut të pajisjeve laboratorike, laboratorë mjekësorë, industri ushqimore dhe laboratorë mjedisorë. Kjo tregon se programi është i lidhur ngushtë me kërkesat e tregut të punës dhe ka efektivitet në orientimin profesional të studentëve. <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Ciklit të Dytë (Programi MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”)</i> <i>Evidenca 2.3.1 – Tabela e orëve laboratorike dhe e ngarkesës mësimore për çdo disiplinë</i> <i>Evidenca 2.2.1 – Plani i detajuar semestral dhe ndarja e ECTS-ve sipas lëndëve</i> <i>Evidenca 2.27 – Raporti i vlerësimit të studentëve për cilësinë e programeve dhe mësimdhënies</i>




	<i>Evidenca 2.27.1 – Analiza e pyetësorëve të studentëve për vitin akademik 2023–2024</i> <i>Evidenca 2.19 – Raporti përmbledhës i studentëve pas diplomimit dhe punësimit të tyre</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është i organizuar në vite dhe semestre, duke siguruar arritjen e objektivave formuese dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Lëndët ofrohen në formë leksionesh, seminare dhe laboratorësh, duke kombinuar njohuritë teorike me praktikën profesionale, në përputhje me standardet e programit të ciklit të dytë. Praktikat laboratorike zhvillohen në laboratorët e specializuar të Departamentit të Bioteknologjisë, duke përfshirë Laboratorin e Bioteknologjisë Molekulare, Laboratorin e Kulturave Indore dhe Fiziologjisë Bimore, Laboratorin e Citologji–Citogjenetikës, Laboratorin e Bioteknologjisë Ushqimore dhe Mikrobiologjisë, Laboratorin e Akuakulturës dhe Laboratorin e Mutagjenezës së Induktuar. Në këto ambiente studentët realizojnë punë eksperimentale me mikroorganizma, specie bimore dhe shtazore, si dhe manipulojnë biomolekula si ARN, ADN dhe proteina, duke përvetësuar kompetenca kërkimore dhe teknike të avancuara. Shpërndarja në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, janë të detajuara në syllabuset dhe planin mësimor të programit, duke garantuar qartësi për studentët dhe ndjekje sistematike të aktiviteteve formuese. Kjo strukturë siguron që rezultatet e të nxënit të përputhen me nivelin e ciklit të dytë të studimeve dhe objektivat e kërkimit shkencor në fushën e bioteknologjisë. <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i Ciklit të Dytë (Programi MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”)</i> <i>Evidenca 2.2.1 – Plani i detajuar semestral dhe ndarja e ECTS-ve sipas lëndëve</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e lëndëve me objektivat formuese dhe ngarkesën mësimore</i> <i>Evidenca 2.3.1 – Tabela e orëve laboratorike për çdo disiplinë</i> <i>Evidenca 2.4 – Plani i aktiviteteve laboratorike në Departamentin e Bioteknologjisë</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është konceptuar duke u bazuar edhe në programe të ngjashme europiane,




teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	duke siguruar përputhshmëri me legjislacionin shqiptar dhe profilet ndërkombëtare. Struktura, emërtimi i lëndëve dhe raporti teori/praktikë janë të përshtatura për arritjen e rezultateve të të nxëniet dhe zhvillimin e kompetencave profesionale. Përputhshmëria ndërkombëtare e programit evidentohet nga pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në programet e mobilitetit Erasmus+ dhe marrëveshjet e UT me programet Erasmus+ dhe Mevlana. Profili ndërkombëtar i programit forcohet gjithashtu nga aktivitetet trajnuese dhe shkëmbimet akademike, si “First Eurobiotech School” (2019) dhe “Second EuroBiotech School” (2022), ku stafi i ftuar nga universitete të ndryshme evropiane mbajti leksione dhe praktika laboratorike për studentët. Ky kombinim i teorisë, praktikës dhe përvojës ndërkombëtare përgatit studentët për punësim në fushat kryesore të bioteknologjisë dhe për vijimin e studimeve të avancuara. <i>Evidenca 1.31–Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Erasmus+</i> <i>Evidenca 1.32 – Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Mevlana</i> <i>Evidenca 1.36 – Mobility Plan për realizimin e praktikave ndërkombëtare</i> <i>Evidenca 2.20 – Mobilitetet Erasmus+ të stafit akademik të përfshirë në program</i> <i>Evidenca 2.21 – Mobilitetet Erasmus+ të studentëve të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.22 – Raport mbi aktivitetin “First Eurobiotech School” (2019)</i> <i>Evidenca 2.23 – Raport mbi aktivitetin “Second Eurobiotech School” (2022)</i> <i>Evidenca 2.24 – Materiale trajnuese dhe dokumentim fotografik i EuroBiotech School</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Organizimi i programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” siguron një raport të përshtatshëm midis formimit teorik dhe praktik, duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin pas diplomimit. Studentët kanë pasur mundësi të marrin pjesë në mobilitete Erasmus+ dhe në bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të Fakultetit.





mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Rezultatet e gjurmimit të alumnëve tregojnë se shumica janë të punësuar në fusha të lidhura me bioteknologjinë, ndërsa 6% e tyre kanë vazhduar studimet në ciklin e tretë. <i>Evidenca 1.31–Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Erasmus+</i> <i>Evidenca 2.21 – Mobilitetet Erasmus+ të studentëve të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.25 – Dokumente mbi bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i> <i>Evidenca 2.19 – Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit dhe punësimit të tyre</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Cilësia e programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” mbështetet në përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve nga stafi akademik, me qëllim sigurimin e kompetencave në përputhje me zhvillimet e fushës dhe kërkesat e tregut të punës. Ky proces realizohet në mënyrë të strukturuar përmes diskutimeve në grup-lëndët, miratimit në mbledhjet e Departamentit të Bioteknologjisë dhe rishikimit të tematikave të tezave të diplomimit, duke siguruar përfshirjen e praktikave bashkëkohore dhe zhvillimeve të reja shkencore. Edhe pse ngarkesa e disiplinave mbetet e pandryshuar, përmbajtja e tyre përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, me përditësim të literaturës bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë. Kjo garanton që studentët të marrin njohuri të përditësuara dhe kompetenca të nevojshme për integrim në tregun e punës dhe për vijimin e studimeve të avancuara. Procesi i përditësimit është i dokumentuar dhe miratohet zyrtarisht nga strukturat përkatëse akademike, duke siguruar transparencë dhe konsistencë në cilësinë e kurrikulës. <i>Evidenca 2.26 – Procesverbali dhe dokumentacioni mbi diskutimet dhe miratimin e përditësimeve të syllabuseve në mbledhjet e Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e përditësuara të disiplinave me literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit</i> <i>Evidenca 2.27 – Tabela përmbledhëse e përditësimit të lëndëve dhe literaturës sipas viteve akademike</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit	Bazuar në Planin Mësimor të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, disiplinat janë të organizuara në



garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	leksione, seminare dhe laboratore, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve. Praktikat laboratorike realizohen në laboratorët e specializuar dhe të mirëpajisur të Departamentit të Bioteknologjisë, duke përfshirë laboratorët e Bioteknologjisë Molekulare, Kulturave Indore dhe Fiziologjisë Bimore, Citologji-Citogjenetikës, Bioteknologjisë Ushqimore dhe Mikrobiologjisë, Akuakulturës dhe Mutagjenezës së Induktuar, ku studentët punojnë me mikroorganizma ushqimorë, specie bimore e shtazore, si dhe manipulojnë biomolekula si ARN, ADN dhe proteina. Shpërndarja në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore për çdo disiplinë, janë dokumentuar në syllabuset përkatëse, duke siguruar përmbushjen e objektivave formuese dhe aftësimit profesional. Cilësia e programit është verifikuar edhe përmes mobiliteteve Erasmus të studentëve, marrëveshjeve ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës, si dhe rezultateve të gjurmimit të shkollimit të mëtejshëm dhe punësimit të studentëve brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidenca 1.22 – Plani Mësimor i programit MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave me ndarjen në leksione, seminare dhe laboratorë</i> <i>Evidenca 2.2 – Programi i ciklit të dytë të studimeve në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale</i> <i>Evidenca 2.2.1 – Plani semestral dhe vlerësimi në kredite për çdo disiplinë</i> <i>Evidenca 2.21 – Mobilitetet Erasmus+ të studentëve të programit</i> <i>Evidenca 1.31 – Marrëveshjet ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës (Erasmus+, Mevlana, etj.)</i> <i>Evidenca 2.19 – Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit dhe punësimit të tyre</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” synon përgatitjen e specialistëve me njohuri të thelluara në fushat e Bioteknologjisë Mjekësore dhe Farmaceutike, Bioteknologjisë Bujqësore, Bioteknologjisë Ushqimore, Bioteknologjisë Mjedisore dhe fushave të lidhura. Përshtatja e programit me kërkesat e tregut të punës është e favorshme dhe evidentohet nga rezultatet e gjurmimit të studentëve pas diplomimit, raportet e vlerësimit të studentëve dhe tabela përmbledhëse e punësimit të tyre. Për të mbajtur një monitorim të vazhdueshëm të punësimit, institucioni ka




	ngritur rrjetin ALUMNI, duke mbajtur kontakte të rregullta me ish-studentët. Studentët që diplomohen në këtë program mund të vazhdojnë arsimimin e tyre në ciklin e tretë, në programin “Doktoraturë në Bioteknologji”, duke siguruar kështu një vijimësi akademike dhe mundësi zhvillimi profesional. Procesi i gjurmimit të alumnëve është funksional dhe ofron të dhëna të vlefshme për nivelin e punësimit të të diplomuarve. <i>Megjithatë, përfshirja e strukturuar e feedback-ut nga punëdhënësit dhe alumni mund të forcohet më tej, në mënyrë që rezultatet e analizave të pasqyrohen në mënyrë më dinamike në përmirësimin e kurrikulës dhe përafrimin me nevojat e tregut të punës.</i> <i>Evidenca 2.19 – Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit dhe punësimit të tyre</i> <i>Evidenca 2.27 – Raportet e vlerësimit të studentëve mbi programin e studimit</i> <i>Evidenca 2.27.1 – Analiza përmbledhëse e rezultateve të vlerësimeve të studentëve</i> <i>Evidenca 2.27.2 – Tabela përmbledhëse e punësimit të të diplomuarve sipas viteve akademike</i> <i>Evidenca 2.27.3 – Dokument mbi krijimin dhe funksionimin e rrjetit ALUMNI të programit</i> <i>Evidenca 2.28 – Programi i studimeve të ciklit të tretë “Doktoraturë në Bioteknologji”</i>			
Konkluzione	<i>Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është i strukturuar në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas kuadrit kombëtar dhe ndërkombëtar. Disiplinat dhe praktikat laboratorike ofrojnë mundësi të qarta për zhvillim të njohurive dhe aftësive, duke mundësuar punësim të drejtpërdrejtë në sektorë prioritarë dhe vijim të studimeve të mëtejshme. Shpërndarja në vite, raporti teori/praktikë dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore janë të përshtatura dhe të dokumentuara. Përputhshmëria ndërkombëtare është evidentuar përmes mobiliteteve Erasmus+ dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera. Gjurmimi i alumnëve tregon punësim të suksesshëm dhe mundësi vijimi të studimeve në ciklin e tretë.</i> <i>Proceset e lidhura me analizën e feedback-ut nga alumni dhe punëdhënësit janë në zhvillim, duke ofruar potencial për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të përmirësimit të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmirësimi i përmbajtjes së programit dhe përshtatja me tregun e punës sigurohet përmes konsultimeve me studentët, aktorët e tregut dhe partnerët akademikë. Përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse: • Senati Akademik - 4 përfaqësues (<i>Evidenca 1.1</i>) • Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë - 3 përfaqësues (<i>Evidenca 2.29</i>) • Komisioni i Kurrikulës - 2 përfaqësues (<i>Evidenca 1.1</i>) • Këshilli i Etikës - 2 përfaqësues (<i>Evidenca 1.1</i>) • Pjesëmarrja e studentëve në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për vlerësimin e programeve akademike (<i>Evidenca 2.30</i>). • Përmirësime të vazhdueshme të syllabuseve dhe përmbajtjes së lëndëve nga Departamenti i Bioteknologjisë (<i>Evidenca 2.26</i>). • Bashkëpunime me partnerë të jashtëm dhe institucione ndërkombëtare: • Erasmus+ (<i>Evidenca 1.31</i>) • Mevlana (<i>Evidenca 1.32</i>) • Marrëveshje të tjera me institucione dhe organizata bashkëpunuese (<i>Evidenca 1.30, 1.33, 1.34</i>) Ky model garanton përfshirjen aktive të studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e programit dhe përshtatjen e tij me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur	Institucioni inkurajon dhe përfshin studentët dhe të diplomuarit në përmirësimin e programit të studimit. Studentët kanë përfaqësim në organet vendimmarrëse të UT, duke përfshirë Senatin Akademik, komisionet e kurrikulës dhe Këshillin e Etikës. Pjesëmarrja aktive e tyre në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) dhe në vlerësimin e programeve akademike evidentohet përmes pyetësorëve të vlerësimit të lëndëve dhe të punësimit pas diplomimit.




ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sugjerimet e studentëve përmirësojnë programin dhe reflektohen në nivel departamenti, duke u ndjekur përmes procedurës zyrtare për ndryshimet e programeve të studimit, pa ndryshuar ngarkesën mësimore aktuale të programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”. <i>Evidenca 1.1 – Dokument mbi përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse të Universitetit të Tiranës (Senati Akademik, komisionet e kurrikulës, Këshilli i Etikës)</i> <i>Evidenca 2.27 – Raportet e vlerësimit të studentëve mbi programin e studimit</i> <i>Evidenca 2.27.1 – Analiza përmbledhëse e rezultateve të vlerësimeve të studentëve</i> <i>Evidenca 2.27.2 – Tabela përmbledhëse e punësimit të të diplomuarve sipas viteve akademike</i> <i>Evidenca 2.32 – Procedura zyrtare për ndryshimet dhe përditësimet e programeve të studimit në nivel departamenti</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson dhe përshtat programin e studimit në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e bioteknologjisë dhe propozimet nga aktorë të ndryshëm. Stafi akademik i Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT, njihet me të rejat dhe i reflekton ato në syllabuset e disiplinave. Bashkëpunimi me rrjete profesionistësh dhe shoqata ndërkombëtare përforcon cilësinë e programit, përfshirë aktivitetet e First EuroBiotech School 2019 dhe Second EuroBiotech School 2022. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me programe si ERASMUS+ dhe Mevlana, si dhe marrëveshjet bilaterale të Universitetit të Tiranës dhe Departamentit të Bioteknologjisë me institucione publike dhe private kanë luajtur një rol kyç në azhurnimin dhe forcimin e programit. <i>Evidenca 2.26 – Procesverbale dhe dokumentacion mbi përmirësimet dhe përditësimet e syllabuseve nga Departamenti i Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.22 – Raport mbi aktivitetin “First EuroBiotech School” (2019)</i> <i>Evidenca 2.23 – Raport mbi aktivitetin “Second EuroBiotech School” (2022)</i> <i>Evidenca 1.31 – Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Erasmus+</i>



	<i>Evidenca 1.32 – Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Mevlana</i> <i>Evidenca 1.30 – Marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata partnere kombëtare dhe ndërkombëtare</i> <i>Evidenca 1.33 – Dokumente mbi projektet e përbashkëta kërkimore dhe trajnime ndërinstytucionale</i> <i>Evidenca 1.34 – Dokumentacion mbi partneritetet akademike dhe institucionale për bashkëpunim në fushën e bioteknologjisë</i>			
Konkluzione	<i>Programi përmirësohet vazhdimisht duke përfshirë studentët, të diplomuarit dhe partnerët akademikë e profesionalë. Studentët marrin pjesë aktive në organet vendimmarrëse dhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, ndërsa njësia përgjegjëse azhuron syllabuset sipas zhvillimeve të fundit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. Standardi është i përmbushur plotësisht, duke siguruar përshtatjen e programit me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin akademik të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi Master Shkencor në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor. Hartimi i tij është në përputhje me misionin dhe strategjinë e Departamentit të Bioteknologjisë, e cila synon përmirësimin e vazhdueshëm të planeve mësimore për të aftësuar studentët sipas nevojave të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Programi gjithashtu funksionon në përputhje me strategjitë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin, për zhvillim dhe integrim, për arsimin dhe për barazinë gjinore. Hartimi dhe zbatimi i programit është në përputhje me statutin dhe misionin e Universitetit të Tiranës, duke garantuar që prioritetet e studimit dhe kërkimit nuk bien ndesh me interesat kombëtare <i>(Evidenca 1.1: Statuti i UT, Nenet 2 dhe 5; Evidenca 1.2: Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028).</i>

	Ky orientim i qartë siguron që studentët të përfitojnë udhëzime dhe bazë të fortë për kërkimin shkencor dhe për zhvillimin profesional në fushat e bioteknologjisë. <i>Evidenca 2.33 – Përshkrimi zyrtar i programit MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 1.5 – Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Bioteknologjisë 2023–2028 (pikat 1, 2, 3)</i> <i>Evidenca 1.6 – Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin</i> <i>Evidenca 1.7 – Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integrimit</i> <i>Evidenca 1.8 – Strategjia Kombëtare për Arsimin</i> <i>Evidenca 1.9 – Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore</i> <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës (Nenet 2 dhe 5)</i> <i>Evidenca 1.2 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023–2028</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore dhe ajo bazë (Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT) nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimore në respekt të lirisë akademike dhe fushës specifike të studimit. Organizimi i Departamentit është në përputhje me Ligjin për IAL dhe aktet nënligjore në fuqi. Departamenti është i strukturuar në Grupet Mësimore Kërkimore, duke përfshirë Grup-lëndët e Bioteknologjisë Molekulare dhe Grup-lëndët e Bioteknologjisë Industriale. Strukturat laboratorike përkatëse përfshijnë laboratorin e Bioteknologjisë Molekulare, laboratorin e Kulturave Indore dhe Fiziologjisë Bimore, laboratorin e Citologji-Citogjenetikës, laboratorin e Bioteknologjisë Ushqimore dhe Mikrobiologjisë, laboratorin e Akuakulturës dhe laboratorin e Mutagjenezës së Induktuar. Ky organizim siguron përputhshmërinë me qëllimet, objektivat dhe kërkesat specifike të programit MSH dhe misionin e Departamentit. Para çdo viti akademik, Departamenti përcjell Planin Mësimor të Programit, i cili miratohet në nivelet përkatëse të FSHN, Departamentit kryesor dhe Rektoratin e UT. Gjithashtu, stafi akademik i angazhuar në program kërkohet të përditësojë syllabuset përkatëse. Njësia kryesore/bazë siguron respektimin e të drejtave të stafit akademik sipas Rregullores së UT, Neni 101 dhe mundësinë e pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përveç kësaj, Departamenti kontribuon në hartimin e Manualit të Vlerësimit të Performancës së Personelit dhe raportimin

	mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor përmes raporteve vjetore. Ky model organizativ garanton koordinim të suksesshëm të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe mbështetje për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe studentëve. <i>Evidenca 2.5 – Struktura Akademike 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.33 – Përshkrimi i programit MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave të programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.7 – Rregullorja e Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.32 – Procedura për miratimin e ndryshimeve në planin mësimor</i> <i>Evidenca 2.26 – Njoftim për përditësim të syllabuseve</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës (Neni 101 mbi të drejtat e stafit akademik)</i> <i>Evidenca 2.34 – Procedura për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare</i> <i>Evidenca – Raportet Vjetore 2021–2024, FSHN, UT</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit “MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” mundëson dhe nxit angazhimin aktiv të studentëve në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Programi i përgatit studentët si teorikisht, ashtu edhe praktikisht, duke përfshirë veprimtaritë e parashikuara në syllabuset e disiplinave dhe duke i motivuar për pjesëmarrje në projekte shkencore, duke i integruar në veprimtari praktike dhe ndërkombëtare që forcojnë njohuritë dhe përvojën profesionale. Departamenti i Bioteknologjisë organizon dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Gjithashtu, studentët inkurajohen të paraqesin referime dhe të marrin pjesë në konferenca, workshop-e dhe seminare shkencore. <i>Evidenca 2.5 – Struktura Akademike e Departamentit të Bioteknologjisë 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.33 – Përshkrimi zyrtar i programit MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave të programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e programit të studimit MSH “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i>

	<i>Evidenca 2.7 – Rregullorja e Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.32 – Procedura për miratimin e ndryshimeve në planin mësimor</i> <i>Evidenca 2.26 – Njoftimi vjetor për përditësimin e syllabuseve nga stafi akademik</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës (Neni 101 mbi të drejtat e stafit akademik)</i> <i>Evidenca 2.34 – Procedura për pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare</i> <i>Evidenca (Raportet Vjetore 2021–2024, FSHN, UT) – Raportet vjetore mbi veprimtarinë kërkimore dhe infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor</i> <i>Evidenca 1.28 – Raporti Vjetor 2021–2024 i FSHN, UT (pika 3.6, fq. 32)</i> <i>Evidenca 2.36 – Raport mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore (Prof. A. Bacu, 2021–2022, pika 3.3/fq. 8)</i> <i>Evidenca 1.36 – Mobility Plan për kryerjen e praktikave pranë Universitetit të Perugias, Itali</i> <i>Evidenca 1.38 – Dokument mbi aktivizimin e studentëve në veprimtaritë e njësisë bazë 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.37 – Programi i Workshop-it të Projektit PKKZH 2023–2024 (pjesëmarrja e studentëve E. Reci, E. Rama)</i> <i>Evidenca 2.38 – Dokument mbi Konferencën Studentore të UT 2023 (pjesëmarrja e studentëve E. Zykollari, E. Reci, S. Sorra, S. Ymet, D. Mackiq, E. Ymeri, E. Cela, E. Duro)</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Institucioni mbështet veprimtaritë e Departamentit të Bioteknologjisë përmes blerjes së materialeve, pajisjeve, reagentëve dhe financimit të projekteve kërkimore-shkencore. Mbështetje të rëndësishme merr edhe stafi akademik i angazhuar në program, përmes financimit të aktiviteteve të tyre kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjes në projekte dhe shkolla ndërkombëtare, për shembull: • First EuroBiotech School 2019 (<i>Evidenca 2.22</i>) • Second EuroBiotech School 2022 (<i>Evidenca 2.23</i>) • Israel-Albania Joint Scientific Activities 2022 (<i>Evidenca 2.24</i>) • Konferenca Ndërkombëtare ICAB 2022 (<i>Evidenca 2.41</i>)



	Për të mundësuar menaxhimin dhe planifikimin e qëndrueshëm financiar, Departamenti i Bioteknologjisë paraqet në fund të çdo viti akademik Planin Buxhetor për vitin pasardhës, i cili miratohet nga njësia kryesore dhe Rektoratit. <i>Evidenca 1.40 – Buxheti i Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.39 – Financimi i stafit akademik nga FSHN, UT gjatë viteve 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.22 – Raport mbi aktivitetin “First EuroBiotech School” (2019)</i> <i>Evidenca 2.23 – Raport mbi aktivitetin “Second EuroBiotech School” (2022)</i> <i>Evidenca 2.24 – Raport mbi aktivitetin “Israel–Albania Joint Scientific Activities” (2022)</i> <i>Evidenca 2.41 – Raport mbi pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare ICAB 2022</i> <i>Evidenca 2.42 – Procedurë për planifikimin dhe miratimin e buxhetit 2021–2024</i>			
Konkluzione	Programi Master Shkencor në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” përcakton qartë objektivat e studimit dhe kërkimit shkencor, në përputhje me misionin e Departamentit dhe strategjitë e institucionit dhe kombëtare. Departamenti nxit dhe koordinon veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të stafit dhe duke ofruar infrastrukturë të specializuar për realizimin e objektivave. Programi motivon studentët të angazhohen në projekte dhe aktivitete kërkimore, përmes pjesëmarrjes në projekte, mobilitete akademike dhe konferenca, duke integruar zhvillimin e aftësive praktike dhe ndërkombëtare që forcojnë njohuritë dhe përvojën profesionale. Mbështetja financiare e institucionit siguron realizimin e qëndrueshëm të veprimtarive studimore dhe kërkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Bioteknologjisë, si njësi bazë e Programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, mbështet grupet mësimore-kërkimore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja. Organizimi i departamentit është në dy grupe: Grupi i Bioteknologjive Molekulare dhe Grupi i Bioteknologjive Industriale. Ky model garanton realizimin e objektivave të programit në kërkim shkencor dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarive akademike, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit në projekte dhe aktivitete të përbashkëta shkencore. Stafi akademik dhe ndihmës-akademik është i angazhuar në program dhe kontribuon në hartimin e projekteve kërkimore, të cilat përfshihen në Planin Buxhetor vjetor të departamentit. Këto projekte mund të financohen totalisht nga FSHN, UT ose me bashkëfinancim. Programi siguron gjithashtu bashkëpunim me institucione kërkimore publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë: • Akademinë e Shkencave të Shqipërisë • Universitetin Bujqësor të Tiranës • Universitetet Publike në rrethe • Asosacionin Ndërkombëtar European Biotechnology Thematic Network Association • Universitetet partnere në kuadër të programeve Erasmus+ <i>Evidenca 2.33 – Përshkrim i përgjithshëm i programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” (misioni, qëllimi dhe objektivat)</i> <i>Evidenca 2.42 – Procedura për planifikimin e buxhetit të Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.22 – Raport mbi aktivitetin “First EuroBiotech School” (2019)</i> <i>Evidenca 2.23 – Raport mbi aktivitetin “Second EuroBiotech School” (2022)</i> <i>Evidenca 2.24 – Raport mbi aktivitetin “Israel–Albania Joint Scientific Activities” (2022)</i> <i>Evidenca 2.41 – Raport mbi pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare ICAB (2022)</i> <i>Evidenca 1.31 – Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me programin Erasmus+</i> <i>Evidenca 1.32 – Marrëveshjet e Universitetit të Tiranës me</i>
---	---


	<i>programin Mevlana</i> <i>Evidenca 1.33 – Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja kërkimore</i> <i>Evidenca 1.34 – Marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private vendore</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor-shkencor, duke angazhuar personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT e konsideron angazhimin e stafit në projekte kërkimore-shkencore një prioritet strategjik, përmes të cilit stafi akademik realizon veprimtari në shërbim të objektivave të programit MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale dhe përparon individualisht. Ky angazhim reflektohet në numrin e konsiderueshëm të projekteve në vazhdim, ku stafi akademik merr pjesë si drejtues ose bashkëpunëtor. Për të nxitur më tej angazhimin e stafit dhe për të rritur kërkesat nga palë të treta për analiza dhe studime, Departamenti deklaron çdo vit akademik shërbimet që ofron për të tretë. Pjesëmarrja e studentëve në realizimin e projekteve kërkimore është e konsiderueshme dhe raportohet rregullisht në nivel njësie kryesore. Departamenti i Bioteknologjisë nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore, duke përfshirë realizimin e praktikave dhe tezave në Universitetin e Perugias, Itali. <i>Evidenca 2.43 – Lista e projekteve në vazhdim të Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT</i> <i>Evidenca 2.44 – Shërbime për të tretë që ofrohen nga Departamenti i Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 1.28 – Raporti Vjetor 2021–2024, FSHN, UT (të dhëna mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar, pika 3.6, fq. 32)</i> <i>Evidenca 1.36 – Mobility Plan për realizimin e praktikave pranë Universitetit të Perugias, Itali</i> <i>Evidenca 1.38 – Aktivizimi i studentëve në veprimtaritë e njësisë bazë 2021–2024</i> <i>Evidenca 2.36 – Raportim mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore (Prof. A. Bacu, 2021–2022, pika 3.3, fq. 8)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia	Departamenti i Bioteknologjisë organizon dhe mbështet aktivitetet që ndihmojnë studentët dhe stafin akademik për arritjen e




përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	objektivave të Programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, duke siguruar realizimin e objektivave të programit në kërkim shkencor dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarive akademike. Këto përfshijnë konferenca dhe workshop-e ndërkombëtare, si ICAB 2022, WEPSD 2021 dhe 2023, EPICATCH Maj 2024, PEPAM 2022 dhe aktivitetet mbi komunitetet bakteriale halofile 2023. Pjesëmarrja e stafit ndërkombëtar dhe shkollat ndërkombëtare, përfshirë First EuroBiotech School 2019, Second EuroBiotech School 2022 dhe Israel-Albania Joint Scientific Activities 2022, forcon ndërkombëtarizimin dhe përgatitjen profesionale të studentëve. Gjithashtu, studentët përfitojnë nga vizita praktike në institucione kërkimore publike, impiante të industrisë ushqimore, trajtimet të ujërave të zeza dhe akuakulturës, duke lidhur mësimin teorik me përvojën praktike dhe duke nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit në projekte dhe aktivitete të përbashkëta shkencore. <i>Evidenca 2.41 – Konferenca Ndërkombëtare ICAB 2022</i> <i>Evidenca 2.45 – Workshop WEPSD 2021</i> <i>Evidenca 2.46 – Workshop WEPSD 2023</i> <i>Evidenca 2.47 – Konferenca EPICATCH, Maj 2024</i> <i>Evidenca 2.48 – Konferenca PEPAM 2022</i> <i>Evidenca 2.49 – Aktivitet kërkimor mbi komunitetet bakteriale halofile 2023</i> <i>Evidenca 2.22 – Raport mbi aktivitetin “First EuroBiotech School” (2019)</i> <i>Evidenca 2.23 – Raport mbi aktivitetin “Second EuroBiotech School” (2022)</i> <i>Evidenca 2.24 – Raport mbi aktivitetin “Israel–Albania Joint Scientific Activities” (2022)</i> <i>Evidenca 1.35 – Dokument mbi vizitat praktike në institucione kërkimore dhe industri (ushqimore, ujërash të zeza dhe akuakulturë)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” është hartuar me objektiva të qarta për aftësimin e studentëve që të jenë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Për të stimuluar aftësimin praktik dhe krijimin e lidhjeve me tregun vendor dhe ndërkombëtar, Departamenti i Bioteknologjisë dhe njësisia kryesore kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione kërkimore-shkencore dhe biznese. Formimi i studentëve mbështetet gjithashtu nga cilësia e syllabuseve të




	disiplinave të programit, nga stafi akademik dhe ndihmës-akademik i specializuar dhe nga laboratorët dhe pajisjet e Departamentit. Njësia kryesore, në bashkëpunim me DSBACK-Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, monitoron dhe raporton çdo vit mbi punësimin dhe suksesin profesional të të diplomuarve, duke analizuar vazhdimisht performancën e programit në lidhje me tregun e punës. <i>Evidenca 2.33 – Përshkrimi i përgjithshëm i programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" (misioni, qëllimi dhe objektivat)</i> <i>Evidenca 1.21 – Rregullorja e programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 2.50 – Studimi i tregut të punës në shërbim të të diplomuarve</i> <i>Evidenca 1.33 – Marrëveshje të nënshkruara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës</i> <i>Evidenca 1.34 – Marrëveshje të bashkëpunimit të Departamentit të Bioteknologjisë me organizata të jashtme</i> <i>Evidenca 2.3 – Syllabuset e disiplinave të programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 1.24 – Lista e stafit akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për programin MSH në BMI</i> <i>Evidenca 1.19 – Inventarët e laboratorëve pranë Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 2.19 – Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit dhe punësimit të tyre</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.





rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).				
Konkluzione	Programi MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" në FSHN, UT, demonstroi një qasje të konsoliduar dhe të strukturuar për zhvillimin e njohurive të thelluara, ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Organizimi i departamentit në grupe mësimore-kërkimore, angazhimi i stafit dhe studentëve në projekte kërkimore, pjesëmarrja në aktivitete dhe konferenca ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi me institucione publike dhe private vendore dhe ndërkombëtare, garantojnë realizimin e objektivave akademike dhe profesionale. Përveç kësaj, programi lidh aftësimin teorik me përvojën praktike dhe përgatit studentët për konkurrencën në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm të suksesit të të diplomuarve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Ky model organizativ reflekton përputhshmërinë me standardet akademike kombëtare dhe praktikën ndërkombëtare, duke e bërë programin të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë dhe ekselencës shkencore, duke siguruar realizimin e objektivave të programit akademik dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarive akademike, si dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit në projekte dhe aktivitete të përbashkëta shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1





Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit Master në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, format kryesore të transmetimit të dijes që përdoren për organizimin e procesit mësimor janë: leksionet, praktikat mësimore, seminarët, detyrat e kursit dhe praktikat profesionale. Programi Master ka të përcaktuara qartë në planin mësimor të gjitha komponentët e ngarkesës akademike, përfshirë orët e mësimit në auditor dhe angazhimin individual të studentëve jashtë auditorit. <i>Evidenca 1.22: Plani mësimor i Programit MSH në BMI</i> <i>Evidenca 2.2: Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10 ASCAL</i> <i>Evidenca 2.3: Sylabusët e disiplinave të Programit MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 2.8: Sylabusët e disiplinave të Programit MSH në BMI që përmbajnë praktika profesionale.</i> <i>Evidenca 2.3.1: Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit MSH në BMI (Tabela 13 ASCAL).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik zotëron aftësitë dhe vullnetin profesional për t’u angazhuar në procesin mësimor, duke iu përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve. Praktikët mësimore realizohen në laboratorë të specializuar, ku studentët punojnë në mënyrë të pavarur, duke ndjekur protokollet përkatëse të eksperimentimit. Ndërsa praktikët profesionale zhvillohen në biznese dhe laboratorë të fushës së Bioteknologjisë, me qëllim forcimin e përvojës praktike dhe aplikimit të njohurive të fituara. Librat bazë dhe ciklet e leksioneve janë të pranishme në bibliotekën e Fakultetit. Krahas literaturës bazë, çdo lëndë shoqërohet edhe me literaturë shtesë, për të nxitur qasjen në burime ndërkombëtare dhe zhvillimin akademik të studentëve. <i>Evidenca 2.3: Sylabusët e disiplinave të Programit. Programi i lëndëve/sylabusët ky përfshihen elementët e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe literaturën.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe	Në përputhje me rregulloren dhe programet e studimit, Universiteti i Tiranës organizon trajnime të vazhdueshme për personelin akademik, me fokus në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe didaktikës universitare.




në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Këto trajnime synojnë përvetësimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirë përdorimin e teknologjive digjitale, mësimin online, organizimin e workshopeve dhe teknika të tjera inovative në arsim. Këto iniciativa synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e përvojës mësimore të studentëve. <i>Evidenca 3.4: Vendimi i senatit Nr. 48, datë 25.11.2021. Ngritja e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke u bazuar në CV-të e stafit akademik, u konstatua se pedagogët që mbulojnë këtë program zotërojnë një formim të mirëfilltë akademik dhe shkencor, i cili garanton zhvillimin e një procesi mësimor cilësor dhe efikas. Gjithashtu, shumica e temave të diplomimit të studentëve ishin punime kërkimore të realizuara në laboratorët e Fakultetit, çka dëshmon për një bashkëpunim të ngushtë dhe të frytshëm ndërmjet personelit akademik dhe studentëve në zhvillimin e projekteve shkencore. <i>Evidenca 1.24: Stafit akademik përgjegjës për programin MSH në BMI-Tabela 2 ASCAL. Evidenca 2.4 CV e personelit akademik. Evidenca 3.5 Stafit akademik përgjegjës për programin MSH në BMI-Tabela 6 ASCAL: Evidenca 3.6 Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre-Tabela 7 ASCAL.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe metodave të mësimdhënies është bazuar në monitorimin e procesit mësimor nga drejtuesit e departamentit dhe në analizimin e pyetësorëve të plotësuar nga studentët. Proces i vlerësimit të lëndëve është realizuar në mënyrë periodike gjatë viteve 2020, 2021, 2022 dhe 2023. Gjetjet e këtyre vlerësimeve i bëhen të ditura personelit akademik dhe analizohen në nivel departamenti për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. <i>Megjithatë, gjatë takimit me studentët e këtij programi, GVJ konstatoi mungesën e evidencave për realizimin e vlerësimit të lëndëve për vitin akademik 2024.</i> <i>Evidenca 2.27: Modeli i pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studentët. Evidenca 3.8: Raport mbi pyetësorin për vlerësimin e mësimdhënies online në FSHN, UT, 2020,2021.</i>




	<i>Evidenca 3.9: Vlerësimi i lëndës nga studenti Sem-I-2021-2022:</i> <i>Evidenca 3.10: Vlerësimi i lëndës nga studenti Sem-II-2021-2022:</i> <i>Evidenca 3.11: Vlerësimi i lëndës nga studenti Sem-I-2022-2023:</i> <i>Evidenca 3.12: Pyetësor i vlerësimi të lëndës nga pedagogu, Dep i Bioteknologjisë, FSHN, UT.</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një nga strukturat kyçe që ndjek dhe mbështet proceset e përmirësimit të vazhdueshëm akademik dhe organizativ. Monitoron i aktivitetin akademik realizohet përmes mekanizmave të brendshëm si analizat e procesit mësimor dhe raportet vjetore të vetëvlerësimit. Universiteti i jep rëndësi zhvillimit profesional të personelit akademik përmes trajnimeve në metodologjitë dhe përdorimit të teknologjive të reja. Këto masa synojnë të garantojnë një përvojë mësimore cilësore për studentët duke forcuar besueshmërinë akademike të institucionit në nivel kombëtar. <i>Evidenca 3.16: Paketa e instrumenteve të cilësisë në UT.</i> <i>Evidenca 3.17: Urdhër dt 30.12.2021 "Për kontrollin e procesit mësimor.</i> <i>Evidenca 3.19: Rregullore për sigurimin e cilësisë.</i>			
Konkluzione	<i>Në lidhje me plotësimin e standartit III.1, GVJ vlerëson se personeli akademik ka kualifikimin e nevojshëm për të garantuar cilësinë e mësimdhënies për programin Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale". Gjatë vizitës u vërejt se personeli akademik ka në fokusin e tij modernizimin e metodave të mësimdhënies Në bibliotekën e Fakultetit ndodhen të gjitha ciklet e leksioneve, tekset mesimore dhe literatura alternative që u vijnë në ndihmë studentëve gjatë realizimit të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standartit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret për vlerësimin e njohurive të studentëve janë të përcaktuara qartë në rregulloren e Universitetit të Tiranës, rregulloren e Departamentit të Bioteknologjisë dhe në rregulloren e programit Master. Të gjitha këto dokumente janë të publikuara në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe në faqen e Departamentit të Bioteknologjisë, duke garantuar aksesueshmëri dhe transparencë për studentët. Gjithashtu, nga shqyrtimi i syllabuseve rezulton se për çdo lëndë janë përcaktuar në mënyrë të qartë format dhe metodat e vlerësimit të dijes, të cilat janë në përputhje me objektivat mësimorë dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Kjo qasje garanton transparencë, drejtësi dhe objektivitet në procesin e vlerësimit të studentëve, duke respektuar standardet kombëtare të arsimit. <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT.</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullorja e programit të studimeve MSH në "Bioteknologjinë Molekulare dhe Industriale".</i> <i>Evidenca 2.7 Rregullorja e Departamentit të Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 3.21 Format e kontrollit të njohurive, një syllabus model.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në syllabus-et e pedagogëve të përfshirë në programin Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", u konstatua se gjatë javës së parë të zhvillimit të çdo lënde, pedagogu prezanton përmbajtjen e modulit, objektivat mësimorë si dhe format dhe kriteret e vlerësimit të njohurive. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë takimit të GVIJ me studentët e programit, ku pjesëmarrësit dëshmuuan se janë të informuar në mënyrë të detajuar mbi strukturën e çdo moduli, përmbajtjen e tij, si dhe raportin ndërmjet leksioneve teorike dhe praktikave laboratorike të parashikuara për secilën lëndë. <i>Evidenca 1.4 Rregullorja e UT23</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullorja e programit të studimeve MSH në "Bioteknologjinë Molekulare dhe Industriale".</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore	Kontrolli i njohurive gjatë procesit mësimor bazohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione, seminare dhe detyra të kursit. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, së




realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	bashku me angazhimin në orët mësimore dhe praktikat laboratorike, përbëjnë komponentët kryesorë që merren parasysh në vlerësimin përfundimtar të studentit. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një sistemi të balancuar vlerësimi, që reflekton jo vetëm performancën në provim, por edhe përkushtimin dhe progresin gjatë gjithë ciklit të mësimi.			
	<i>Evidenca 3.21 Format e kontrollit të njohurive, një sylabus model.</i>			
Konkluzione	Pas vizitës së realizuar dhe analizimit të dokumentacionit, GVJ arriti në përfundimin se Departamenti i Bioteknologjisë disponon një kuadër të plotë ligjor, mbikëqyrës dhe procedural për vlerësimin e njohurive të studentëve gjatë gjithë procesit mësimor. Ky kuadër përfshin rregullore të miratuara në nivel institucional dhe departamental, praktika të standardizuara për vlerësimin që garantojnë zbatimin korrekt të kriterëve të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kontrolli i njohurive është në përputhje me rregulloren e studimeve dhe është i përcaktuar qartë në sylabus-in e çdo lënde. Aftësitë profesionale dhe praktike të studentëve vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit, për secilën lëndë, përmes pikëzimit të angazhimit praktik. Si komponentë vlerësimi shërbejnë gjithashtu seminarët dhe detyrat e kursit, të cilat kontribuojnë në ndërtimin e një profili të plotë të performancës së studentit. Vlerësimi përfundimtar i studentit bazohet në një shumë të ponderuar të rezultateve të arritura në seminare, praktika mësimore dhe provimin final, duke reflektuar kështu progresin dhe përfshirjen gjatë gjithë procesit mësimor. <i>Evidenca 2.3 Sylabuset e disiplinave të MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 3.21 Format e kontrollit të njohurive, një sylabus model.</i>

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Format e testimit dhe vlerësimit bazoheshin kryesisht në provime me shkrim, në përputhje me rregulloren përkatëse të provimeve. Për të rritur transparencën dhe efikasitetin, studentët njoftoheshin në mënyrë automatike për rezultatet e arritura, duke garantuar në të njëjtën kohë ruajtjen e konfidencialitetit të tyre. Ky sistem i informimit siguron besueshmëri në procesin e vlerësimit, duke respektuar privatësinë e studentëve.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi final i çdo studenti bazohet në shumën e pikëve të grumbulluara nga seminarët, praktikat mësimore dhe provimi përfundimtar. Personeli akademik i modulit, informonte çdo student në mënyrë të detajuar para provimit për pikët e fituara në seminare, praktika dhe detyra kursi. <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 58-59-60, faqe 30-32.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 58, faqe 31.</i> <i>Evidenca 3.22: Përcjellja e komisionit të provimit gjatë 2021-2024.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Duke u bazuar në rregulloren e provimeve, vlerësimi i njohurive, përfshin seanca rishikimi për provimet që bazoheshin në takimin me pedagogun e lëndës dhe diskutimin dhe komentimin mbi tezën e provimit. Studentëve ju lihej dy ditë kohë për të diskutuar me pedagogun përkatës për çdo paqartësi të mundëshme. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI, neni 60, pika 3).</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI, neni 10.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Komisioni përgjegjës i provimit ndalon rreptësisht kopjimin gjatë formave të ndryshme të vlerësimit të dijes ku bejnë pjesë seminarët, detyrat e kursit dhe provimet. Studentët gjithashtu janë në dijeni që punimi final i tezës së diplomës duhet të jetë origjinal dhe të mos ketë plagjiatur. <i>Gjithsesi u vërejt se Fakulteti i Shkencave të Natyrës nuk dispononte një server të aftë për të evdntuar plagjiaturën.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 59, faqe 31, pika 5-7.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive	Dhënia e rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale realizohej konform rregulloreve të provimeve. Në takim e




profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	realizuar me studentët u vërejt se ky afat ishte respektuar me përpikmëri përgjatë dy viteve të studimeve master. Student njihen me rezultatet e provimeve brenda harkut kohor prej 10 ditëve të punës pas provimit me shkrim. <i>Evidenca 1.4: Rregullore e programit të studimit MSH në BMI, neni 10.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI, neni 60, pika 3.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Programi Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", u garanton studentëve rishikimin e provimeve në bashkëpunim me personelin akademik. Studentët e marrin në mënyrë elektronike njoftimin me email në sajë të sistemit Pitagora. Pas marrjes ata kanë të drejtë që brenda harkut kohor prej dy ditësh të takojnë profesorin e lëndës për të sqaruar ndonjë paqartësi në lidhje me provimin. <i>Evidenca 1.1: Statuti i UT, Neni 125, fq 69</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 60, fq 30</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH dhe BMI, neni 10.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH dhe BMI, neni 10, pika 3.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rastet e ankimimit studentët kanë të drejtë të formulojnë një ankesë pranë drejtuesit të Departamentit të Bioteknologjisë, i cili ka të drejtë të ngrejë një komision për të shqyrtuar ri-vlerësimin e provimit nëse e gjen të drejtë ankesën e studentit. Gjithsesi gjatë takimeve të realizuara nga GVJ, nuk kishte asnjë ankesë nga studentët. <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, Neni 125, fq 69.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullorja e Universitetit të Tiranës, neni 60, fq 30.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI, Neni 60, pika 3.</i>
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar GVJ konkludon se Programi Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", vlerësimi i dijeve është konform rregulloreve të IAL-së duke mundësuar ruajtjen e konfidencialitetit dhe të drejtën e ankimimit për çdo student. Ky proces është transparent duke mundësuar përmbushjen e standardit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, përbëhet nga 17 module dhe është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 21.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Ky program ka një kohëzgjatje akademike prej dy vitesh dhe përmban 120 kredite (ECTS), duke respektuar parimet e Kartës së Bolonjës. Programi është i strukturuar me një ndarje të qartë të orëve teorike dhe praktike, me qëllim garantimin e zhvillimit të aftësive profesionale të studentëve. <i>Evidenca 2.3.1: Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit-Tabela 13 ASCAL.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Duke u bazuar në kurrikulën e programit të studimit Master, vërehet prania e moduleve që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, si p.sh. Biostatistika e avancuar dhe Anglishtja për qëllime shkencore dhe profesionale. Aftësitë në komunikim dhe ndërveprim profesional nxiten përmes detyrave të kursit, të cilat zhvillohen në disa module, si dhe nëpërmjet praktikave profesionale të integruara në program. <i>Evidenca 1.22: Plani mësimor i programit MSH në BMI</i> <i>Evidenca 2.3: Syllabuset e disiplinave të programit MSH në BMI</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	Personeli akademik orienton studentët gjatë javës së parë të semestrit në lidhje me objektivat e lëndës, ndarjen e orëve midis leksioneve dhe praktikave, si dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive. Ky program kontribuon në aftësimin praktik të studentëve, veçanërisht në teknikat laboratorike, përdorimin e instrumenteve analitike, interpretimin e të dhënave, si dhe në bioinformatikë. Gjithashtu, programi mbështet zhvillimin e autonomisë së studentëve, duke u ofruar atyre mundësinë për të

rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	përfunduar praktikatat mësimore përpara provimeve dhe për të zhvilluar konsulta të rregullta me pedagogët. <i>Evidence 3.12 Pyetësor i vlerësimit të lëndës nga pedagogu i Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT.</i> <i>Evdienca 2.3: Syllabuset e disiplinave të programit MSH në BMI.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në programin Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", mësimdhënia zhvillohet përmes leksioneve, praktikave mësimore, seminareve, detyrave të kursit, praktikës profesionale, si dhe përmbillet me temën e diplomës. Personeli akademik, i përbërë kryesisht nga pedagogë me gradë shkencore "Profesor" dhe me kualifikime të vazhdueshme, garanton zbatimin e standardeve akademike dhe cilësinë e programit. Gjatë praktikave mësimore dhe realizimit të detyrave të kursit, stafi pedagogjik orienton studentët në punën në grup, zgjidhjen e situatave problemore dhe në zhvillimin e mendimit kritik. <i>Evidenca 3.24: të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të Departamentit të Bioteknologjisë-Tabela 19 ASCAL.</i> <i>Evidenca 3.5: Stafi akademik përgjegjës për MSH në BMI, tabela 6.1-6.3 e ASCAL.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Leksione të hapura janë zhvilluar gjatë praktikave mësimore të organizuara pranë industrive ushqimore, farmaceutike dhe sektorëve të tjerë përkatës. Gjithashtu, seminare mbi zhvillimet teknologjike dhe leksione të hapura janë mbajtur edhe nga lektorë të huaj që kanë vizituar Departamentin e Bioteknologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në kuadër të projekteve të ndryshme bilaterale dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. <i>Evidenca 3.25: Përmbledhje e orëve të hapura/seminare të realizuara nga stafi efektiv ose me kontratë mbi zhvillimet e reja të bioteknologjisë.</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara	Shumë punime shkencore të personelit akademik kishin të përfshirë dhe studentët të cilët ishin të përfshirë në punën laboratorike. Programi Master kishte marrëveshje Erasmus me një

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	sërë institucionesh partnere në Europë mbështesnin studentët në të mirë me bursa studimi në realizimin e studimeve për një semester ose praktikës profesionale. Këto mundësi ndërkombëtare kanë kontribuar në përgatitjen e studentëve për tregun e punës në një kontekst global. <i>Evidenca 1.31: Lista e marrëveshjeve Erasmus+ të Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 3.25: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT-Tabela 20 ASCAL.</i> <i>Evidenca 3.27: Marrëveshja me institucionet dhe organizata bashkëpunuese-Tabela 5 ASCAL.</i>			
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në gjetjet e konstatuara gjatë vizitës në terren, konkludohet se procesi i vlerësimit të dijeve të studentëve realizohet në mënyrë të drejtë dhe objektive, duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë, si dhe të drejtën e studentëve për ankimim dhe zgjidhjen e tij në përputhje me procedurat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Programi i Masterit disponon një rregullore të detajuar, e cila përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve që duhet të përmbushen përpara diplomimit. Rregullorja u mundëson studentëve të diplomohen në tre sezona zyrtare: Korrik, Shtator dhe Mars. Për të shmangur penalizimin e studentëve në raste të veçanta, programi parashikon gjithashtu mundësinë e sezoneve shtesë të provimeve dhe diplomimeve në muajt Prill dhe Tetor, nëse kjo kërkohet nga Këshilli Studentor dhe miratohet nga strukturat përkatëse. Kjo qasje tregon përkushtimin e institucionit në ofrimin e një mjedisi akademik gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave të studentëve. <i>Evidenca 1.21: Rregullore e programit të studimit MSH në BMI.</i>

	<i>Evidenca 1.4: Rregulloret e UT.</i> <i>Evidenca 2.5: Struktura e viteve akademike 2021-2024.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Bioteknologjisë, në përputhje me Rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Universitetit të Tiranës, ka përcaktuar tutorët për studentët e vitit të parë dhe të dytë. Këta tutorë organizojnë takime informuese me grupet përkatëse dhe, sipas kërkesave, konsultime me pedagogët e lëndëve. Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka përcaktuar një kalendar të rregullt për zhvillimin e sezoneve të mbrojtjes së diplomave - tre sezone fikse (Korrik, Shtator, Mars) dhe deri në dy shtesë sipas kërkesës së Këshillit Studentor. Ky kalendar publikohet rregullisht në faqen zyrtare të FSHN. Rregullat e shkrimit të tezës së diplomës, të përcaktuara në përputhje me rregulloren e UT për ciklin e dytë të studimeve, u komunikohen studentëve nga tutorët përmes takimeve të dedikuara. Ky organizim ofron një strukturë të qartë dhe të formalizuar për asistencën e studentëve gjatë përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për programet Master diplomimi i studentëve bazohet në punimin e diplomës dhe ky kriter nuk mund të aplikohet.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Paraprakisht, personeli akademik i programit Master përgatit një listë me tema diplome, e cila i bëhet e njohur studentëve gjatë vitit të parë të studimeve. Personeli akademik orienton dhe mbështet studentët në përzgjedhjen e temave, të cilat duhet të jenë në përputhje me fushat përkatëse të studimit. Pedagogët që udhëheqin punën me studentët për temat e diplomës kanë detyrimin dhe përgjegjësinë të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme përmes literaturës, materialeve didaktike, asistencës në kërkimin shkencor në laborator, përpunimin e rezultateve dhe shkrimin akademik. Në përfundim të prezantimit të temës së diplomës, komisioni i vlerësimit i komunikon çdo studenti vlerësimin përkatës. <i>Evidenca 3.28 Rregulloret e Diplomimit të studentëve në ciklin të UT, Vendimi Nr. 13 dt 20.07.2022, Neni 5, Diplomimi me punim diplome.</i>

	<i>Evidenca 3.29: Modele platformsh të tezës së diplomës në programin MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 3.30: Komunikime me email i udhëheqësit me studentët e MSH gjatë punës për shkrimin e tezës së diplomit MSH në BMI.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Çdo student zotohen që punimi shkencor që realizon të jetë autentik dhe të shmangë çdo formë plagjiature. Personeli akademik ndihmon studentët gjatë realizimit të kërkimit shkencor në laborator, përpunimit të rezultateve dhe shkrimit akademik. Studentëve u ofrohet mundësia e përdorimit të pajisjeve laboratorike nën supervizionin e personelit akademik, duke respektuar rreptësisht protokollet e sigurisë dhe procedurat laboratorike. <i>Evidenca 1.16: Mjediset e fakultetit/të njësive bazë, FSHN, UT, tabela ASCAL 16.</i> <i>Evidenca 1.19: Invertaret e Laboratoreve pranë departamentit të Bioteknologjisë.</i> <i>Evidenca 1.39: Lista e studentëve të programit MSH në BMI që kanë kryer praktika në kuadër të tezave MSH pranë institucioneve bashkëpunuese.</i> <i>Evidenca 3.31: Foto-album i studentëve të programit MSH në BMI gjatë realizimit të tezave të diplomës në laboratorët e Departamentit të Bioteknologjisë.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i provimit vendos notën përfundimtare me unanimitet, duke u bazuar në vlerësimet individuale të secilit anëtar të komisionit. Nota përfundimtare llogaritet si mesatarja aritmetike e këtyre vlerësimeve. Pas përfundimit të mbrojtjes së diplomës, kryetari i komisionit shpall publikisht notat përkatëse për secilin student. Rezultatet përfundimtare dokumentohen dhe arkivohen në sekretarinë mësimore përmes procesverbalit zyrtar të mbrojtjes së diplomës. <i>Evidenca 3.28: Rregullore e diplomimit të studentëve në ciklin e dytë të UT, Vendimi Nr 13 dt 20.07.2022, Neni 5, Diplomimi me punim diplome, pika 5.</i> <i>Evidenca 3.32: Model procesverbalit provimi për diplomin e studentëve të MSH në BMI.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e	Pas përfundimit me sukses të studimeve dhe shlyerjes së të gjitha detyrimeve akademike dhe financiare, çdo student pajiset me diplomën e Masterit Shkencor në "Bioteknologji Molekulare dhe




diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Industriale”. Lëshimi i diplomës bëhet konform rregullores së Universitetit të Tiranës, dhe për studentët që kanë përfunduar studimet me rezultate të shkëlqyera, jepet certifikata “Medalje e Artë” si vlerësim i posaçëm për arritjet e tyre. Çdo diplomë është e firmosur dhe e vulosur nga Rektori dhe Dekani i Fakultetit, dhe përmban në mënyrë të detajuar: emrin, mbiemrin, ciklin e studimit dhe kodin unik të studentit. <i>Megjithëse procesi i diplomimit dhe pajisjes me dokumentacionin përfundimtar është i standardizuar dhe në përputhje me rregulloret institucionale, konstatohet mungesa e një mekanizmi të formalizuar për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve dhe formimin e vazhdueshëm profesional pas përfundimit të studimeve. Kjo kufizon përdorimin sistematik të feedback-ut nga alumni dhe punëdhënësit si pjesë e procesit të përmirësimit të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 70, pika 3, fq. 36.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Çdo student regjistrohet në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe në Regjistrin Shtetëror të Diplomave, pas përfundimit me sukses të studimeve. Nga kontrolli i kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) në sekretarinë mësimore, u konstatua se i gjithë dokumentacioni i programit Master, përfshirë Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin e Arritjeve Akademike, ruhej në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 101. <i>Evidenca 3.35: Rregjistri themeltar të studentëve-demostrime</i> <i>Evidenca 3.36: Rregjistrin arritjeve akademike-demostrim.</i> <i>Evidenca 3.37: Rregjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, FSHN, UT</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka vendosur procedura dhe struktura të qarta për menaxhimin e detyrimeve përfundimtare të studentëve, duke përfshirë rregulloret e diplomimit, përcaktimin e tutorëve, sezonet fikse dhe shtesë të diplomimit, si dhe udhëheqjen e studentëve gjatë përgatitjes së tezës. Studentët mbështeten në realizimin e kërkimeve në laborator dhe në përdorimin e infrastrukturës,</i>





	<i>ndërsa procesi i vlerësimit dhe dokumentimit të rezultateve është i standardizuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor. Po ashtu, në përfundim të studimeve u jepet diploma dhe suplementi i diplomës, duke respektuar kërkesat ligjore dhe rregulloret institucionale.</i> <i>Megjithatë, mbështetja e studentëve kufizohet kryesisht në fazën e studimeve dhe të diplomimit, ndërsa mungon një sistem i plotë e i formalizuar për formimin e vazhdueshëm profesional dhe ndjekjen e karrierës së të diplomuarve. Kjo dobësi e kufizon përdorimin e feedback-ut nga alumni dhe punëdhënësit si bazë për zhvillimin dinamik të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet ne rastin e Programit MSH ne "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.




Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet në rastin e Programit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale", FSHN, UT.			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka	Zhvillimi i programit Master është në kompetencën e Departamentit të Bioteknologjisë, ndërsa personeli akademik i angazhuar përbëhet nga pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm. Pedagogët që kontribuojnë në këtë program janë kryesisht me titullin akademik "Profesor" dhe kanë përvojë të gjatë në procesin e mësimdhënies. Personeli akademik përfshin ekspertë të fushës, të cilët kanë marrë pjesë aktive në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si Erasmus+, Horizon, COST etj. Lëndët e përzgjedhura për fushat kërkimore janë në përputhje të plotë me programin e studimit, si dhe me programe të ngjashme në universitete simotra ndërkombëtare.



fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi dhe kualifikimet e tyre për 3 vitet e fundit akademike, paraqiten si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të DB</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>5</td><td>1</td><td>5</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>5</td><td>1</td><td>5</td><td>1</td><td>4</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>6</td><td>-</td><td>5</td><td>1</td><td>5</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr. proc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>16</td><td>4</td><td>15</td><td>4</td><td>15</td><td>3</td></tr></table> Evidenca; RVB aneks tabelat përmbledhë, tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Evidenca 3.24: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik të Departamentit të Bioteknologjisë-Tabela 19 ASCAL.	Kualifikimi i stafit akademik të DB	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	5	1	5	-	6	-	Prof. Asoc.	5	1	5	1	4	1	Dr/Phd	6	-	5	1	5	1	Dr. proc	-	-	-	-	-	-	Msc.	-	2	-	2	-	1	Gjithsej	16	4	15	4	15	3
Kualifikimi i stafit akademik të DB	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof. Dr	5	1	5	-	6	-																																																		
Prof. Asoc.	5	1	5	1	4	1																																																		
Dr/Phd	6	-	5	1	5	1																																																		
Dr. proc	-	-	-	-	-	-																																																		
Msc.	-	2	-	2	-	1																																																		
Gjithsej	16	4	15	4	15	3																																																		
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore është në përputhje të plotë me kornizën ligjore, duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MARS) Nr. 29, datë 10.09.2018. Personeli akademik i brendshëm përbën përqindjen më të madhe të angazhimit në procesin e mësimdhënies, mbi 70%, krahasuar me personelin akademik të jashtëm. Në ndonjë rast të izoluar kishte Pedagogë që kishin një ngarkesë mësimore tepër të lartë. Evidenca 2.6: Ngarkesa mësimore e mbuluar nga staf akademik, Tabela 12, ASCAL. Evidenca 4.1: Udhëzimi i MASR Nr 29, dt 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL.																																																							
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e	Nga verifikimet e kryera nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, u vërejt se programi Master karakterizohej nga një qëndrueshmëri e lartë e personelit akademik. Personeli akademik ishte i punësuar mbi bazën e kontratave të punës, ku përfshihen edhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke siguruar stabilitet dhe përkushtim në realizimin e procesit mësimor.																																																							



punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Evidenca 3.5: Stafit akademik përgjegjës për programin MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale".</i> <i>Evidenca 4.2: Model kontrate punësimi për stafin akademik të brendshëm dhe atë të ftuar pranë programit MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale, FSHN, UT.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit të personelit akademik për kategori të ndryshme bazohet në Statutin e Universitetit, i cili është në përputhje me Kodin e Punës. Ky proces përfshin një sërë hapash dhe kriteresh të përcaktuara, duke respektuar kuadrin ligjor dhe rregulloret e brendshme të institucionit të arsimit të lartë (IAL). Punësimi i personelit akademik bëhet kryesisht në rastet kur është e nevojshme të zëvendësohet një anëtar i stafit që ka dalë në pension ose kur lindin kërkesa shtesë për të përballuar ngarkesën mësimore të programeve të studimit. Departamenti përgjegjës përgatit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të rekrutimit, duke u bazuar në natyrën e lëndës ku do të angazhohet personeli akademik. Kriteret e përgjithshme përfshijnë mesataren e studimeve, punimet shkencore, dhe trajnimet e ndryshme, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij. Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët dhe thirrja publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Përzgjedhja e kandidatëve realizohet nga një komision i veçantë, ku bëjnë pjesë përfaqësues nga Rektorati, Fakulteti, Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. <i>Evidenca 1.1 Statusi i Universitetit të Tiranës, nenet 67,68,69, fq.42-44).</i> <i>Evidenca 4.3: Njoftim për vend të lire pune për stafin akademik/ndihmës-akademik pranë FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 4.4: Praktikë rekrutimi e stafit akademik pranë Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore,	Programi i studimit përfshin në mënyrë integrale edhe personelin ndihmës akademik, i cili ofron mbështetje të rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Personeli ndihmës përbëhet kryesisht nga individë që kanë përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Falë trajnimeve periodike dhe përfshirjes së vazhdueshme në punët laboratorike, ata kanë zhvilluar një përvojë të konsiderueshme profesionale gjatë viteve.




sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<i>Evidenca 1.24: Stafit akademik përgjegjës për programin MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale-Tabela 2 ASCAL.</i> <i>Evidenca 2.14: CV e personelit ndihmës-akademik).</i> <i>Evidenca 2.15: Rregullore për laboratorët dhe stafin ndihmës akademik-Departamenti i Bioteknologjisë.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVJ) realizoi një kontroll pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, ku konstatoi ekzistencën e të gjitha dosjeve për secilin pedagog, si dhe përditësimin e CV-ve të personelit akademik të angazhuar në këtë program. Këto CV ishin të standardizuara për të gjithë personelin akademik, duke kontribuar në garantimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe efikasitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore akademike. <i>Evidenca 1.17: Organigrama e FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 2.4: CV e personelit akademik.</i> <i>Evidenca 2.6: Ngarkesa mësimore stafit akademik të programit MSH në BMI-Tabela 4 ASCAL.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Përgjatë viteve, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike, institucione arsimore të larta (IAL) brenda dhe jashtë vendit, institute kërkimore shkencore, kompani private dhe laboratore të ndryshme. Këto institucione ofrojnë një mbështetje të rëndësishme në realizimin e praktikës profesionale, e cila supervizohet nga personeli akademik i angazhuar në këtë program. Gjithashtu, këto marrëveshje kanë kontribuar edhe në realizimin e temave të diplomës dhe kërkimit shkencor. Ky angazhim institucional ndihmon në sigurimin e cilësisë së përvojës praktike dhe në përafrimin e aftësive të studentëve me kërkesat reale të tregut të punës. <i>Evidenca 1.33: Marrëveshje të nënshkruara nga FSHN gjatë 2021-2025.</i> <i>Evidenca 1.34: Marrëveshje të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione dhe organizata bashkëpunuese.</i> <i>Evidenca 1.35: Veprimtari të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione të tjera.</i> <i>Evidenca 1.36: Mobility plan për kryerjen e praktikave në kuadër të realizimit të tezave MSH nga studentët MSH në BMI.</i>





	<i>Evidenca 3.27: Marrëveshje të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione dhe organizata bashkëpunuese-Tabela 5 ASCAL.</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Departamenti i Bioteknologjisë ka ngritur një sistem tutorimi, i përbërë nga stafi akademik dhe koordinatori akademik, me qëllim mbështetjen e mbarëvajtjes normale të praktikës mësimore. Personeli akademik ofron ndihmën e tij në mbikëqyrjen e realizimit të praktikës profesionale, në bashkëpunim me personelin e institucioneve ku praktika zhvillohet. Gjithashtu, stafi akademik siguron mbështetje studentëve edhe gjatë përgatitjes së protokollit të praktikës. <i>Evidenca 4.5: Koordinator i akademik dhe personeli akademik në ndjekje të praktikës së studentëve të MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale pranë UNIPG, Itali.</i>			
Konkluzione	<i>Rekrutimi i personelit të ri akademik realizohet në përputhje me rregulloret e institucionit duke garantuar transparencën. Stafi ndihmës mësimor kishte mbaruar i gjithi studimet në FSHN duke dhënë një ndihmesë reale në realizimin e praktikave mësimore. FSHN kishte lidhur një numër të madh marrëveshjesh duke garantuar ecurinë e praktikës profesionale e cila ndiqej nga personeli akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke u bazuar në vizitën e realizuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) në njësinë kryesore për vlerësimin e infrastrukturës, u vërejt se procesi mësimor zhvillohej në disa godina të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Departamenti i Bioteknologjisë kishte në dispozicion auditorë për leksione, salla për seminare dhe laboratorë të përshtatshëm për realizimin e suksesshëm të programit. Në të njëjtën kohë, ishin të sigurura edhe ambientet mbështetëse për Bibliotekën, Financën, Burimet Njerëzore, Zyrën e Karrierës dhe personelin ndihmës mësimor.





	<i>Evidenca 1.16: Mjediset e Fakultetit/njësitë bazë, FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e bibliotekës, FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 4.8: Kapacitetet pritëse për studentët e MSH në BMI, FSHN, UT.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se Departamenti i Bioteknologjisë zotëronte ambiente të përshtatshme për realizimin e programit të studimit Master. Këto ambiente përfshijnë salla leksionesh, laboratorë didaktikë dhe kërkimorë-shkencorë, si dhe zyra për personelin akademik dhe ndihmës mësimor. Gjithashtu, pajisje kompjuterike ishin të pranishme në të gjitha ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe ishin të pajisura me programet bazë si Word, Excel, PowerPoint, etj. Shërbimi i internetit ishte i pranishëm në të gjitha ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, duke mundësuar një infrastrukturë funksionale për mësimdhënie dhe kërkim. Personeli akademik ofronte një platformë online, përmes së cilës studentët kishin akses në materialet mësimore, ciklet e leksioneve dhe prezantimet në formatin PowerPoint (PPT). <i>Evidenca 1.16: Mjediset e Fakultetit/njësitë bazë, FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 1.19: Inventari i laboratoreve pranë Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN.</i> <i>Evidenca 4.9: Inventarët e paisjeve të zyrës, paisjeve elektronike të stafit akademik të Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në mbështetje të procesit mësimor, Departamenti i Bioteknologjisë kishte në dispozicion një sërë laboratorësh të specializuar, të cilët shërbejnë gjithashtu si bazë për zhvillimin e kërkimit shkencor. Këta laboratorë janë të pajisur me aparaturë përkatëse dhe bashkëkohore, të siguruar falë pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si: Horizon Europe, PKKZH, Erasmus+ (Building Capacity), etj. Laboratorët përdoren gjithashtu për realizimin e temave të diplomës, duke i mundësuar studentëve përfshirje aktive në punën kërkimore dhe zhvillimin e aftësive praktike. <i>Evidenca 1.19: Inventari i laboratoreve pranë Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN.</i> <i>Evidenca 2.4: Buxheti i FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 4.9: Inventarët e paisjeve të zyrës, paisjeve elektronike të stafit akademik të Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN, UT.</i>




Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” kishte në dispozicion dy laboratorë të Teknologjisë së Informacionit, konkretisht laboratorin e Biostatistikës dhe laboratorin e Bioinformatikës. Këto laboratorë ishin të pajisur me software të specializuar, të cilët mundësonin përdorimin e programeve të ndryshme statistikore, duke garantuar mbështetje cilësore në përpunimin dhe analizën e të dhënave. <i>Evidenca 1.16: Mjediset e Fakultetit/Njësive bazë, FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 1.19: Inventari i laboreve pranë Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN.</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vërejti se Departamenti i Bioteknologjisë kishte nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione partnere, të cilat mundësonin realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale për studentët. Praktikant profesional zhvilloheshin gjithashtu edhe me universitete jashtë vendit, falë bashkëpunimeve të vendosura në kuadër të projektit Erasmus+. <i>Evidenca 3.27: Marrëveshje me institucione dhe organizata bashkëpunuese-Tabela 5 ASCAL.</i> <i>Evidenca 1.35: Veprimtari të Departamentit të Bioteknologjisë me institucione të tjera.</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e ofruar, u konstatua se personeli akademik i angazhuar në programin Master plotëson kriteret ligjore të rekrutimit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret në fuqi. I gjithë personeli ndihmës akademik ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN), duke dhënë një ndihmesë të vlefshme në realizimin e praktikave mësimore dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitën së GVJ në mjediset e bibliotekës dhe librarisë së FSHN, u vërejt prania e literaturës bazë për modulet dhe lëndët e programit. Kjo literaturë ishte përcaktuar qartë në syllabuset e cdo lënde dhe moduli si në format fizike ashtu edhe digjitale. Janë të disponueshme hapësira mbështetëse për personelin akademik të cilat janë në funksion të procesit mësimor. <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës, FSHN, UT, Raportet Vjetore 2021-2022.</i> <i>Evidenca 4.10: Tekste mësimore të miratuara për programin MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale".</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke u mbështetur në vizitën e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), u konstatua se Departamenti i Bioteknologjisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) disponon një fond të veçantë të dedikuar për pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore, e cila përdoret në kuadër të programit të studimit. Ky fond ka mundësuar përmirësimin periodik të fondit ekzistues, duke siguruar akses të studentëve dhe stafit akademik në burime të përditësuara dhe të standardeve ndërkombëtare. <i>Evidenca 2.40: Buxheti FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës, FSHN, UT.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka mësimore ndodhet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe ishte lehtësisht e aksesueshme nga studentët. Ajo dispononte një hapësirë të bollshme dhe funksionimi i saj rregullohej nga një rregullore e brendshme, e cila siguron përdorimin e drejtë dhe efikas të shërbimeve të saj. Personeli ndihmës garantonte aksesin e studentëve në bibliotekë, ndërsa skedarët e organizuar lehtësonin gjetjen e materialeve bibliografike në mënyrë të shpejtë dhe të saktë. <i>Evidenca 4.11: Rregullorja e brendshme e Bibliotekës, FSHN, UT</i> <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës, FSHN, UT</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si:	Nga vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u konstatua se biblioteka ishte e pajisur me një fond të pasur literaturë, si në




tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. Në këtë fond përfshiheshin një numër i konsiderueshëm tekstesh mësimore, libra, periodikë, doktratura dhe revista shkencore. Gjithashtu, biblioteka ofronte edhe revistën periodike të Universitetit, duke siguruar akses të plotë në burimet më të fundit akademike dhe kërkimore. <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës FSHN, UT</i> <i>Evidenca 4.10: Tekste mësimore të miratuara për programin MSH në "Bioteknologji molekulare dhe Industriale"</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Pas regjistrimit, studentët mund të përfitonin shërbimet e bibliotekës, e cila garantonte akses të barabartë për të gjithë përdoruesit. Ky shërbim ishte falas dhe përfshinte aksesin për studentët dhe personelin akademik. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ofronte gjithashtu mundësi aksesimi online në një sërë platformash të njohura ndërkombëtare, si JSTOR, IOP, MSP, etj., duke siguruar burime të vlefshme për studim dhe kërkim shkencor. <i>Evidenca 4.13: Manuali i aksesit në bibliotekën online</i> <i>Evidenca 4.7: Kapacitetet e bibliotekës online.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ishte e pajisur me kompjutera që mundësonin studentëve akses në katalogun bibliografik online dhe në revista të ndryshme shkencore. <i>Megjithatë, u vërejt se numri i kompjuterave ishte i kufizuar dhe duhet të rritet për të siguruar akses të mjaftueshëm për të gjithë studentët.</i> <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës FSHN, UT</i> <i>Evidenca 4.7: Kapacitetet e bibliotekës online.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ishte e hapur gjatë gjithë ditëve të javës, nga ora 08:00 deri në orën 16:00. Ky orar garantonte aksesin e të gjithë studentëve gjatë zhvillimit të orarit mësimor. Gjithashtu, biblioteka qëndronte e hapur edhe gjatë sezonit të provimeve, për t'u ardhur në ndihmë studentëve në përgatitjen e tyre akademike. <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 4.6: Kapacitetet e Bibliotekës FSHN, UT</i>




Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Pasurimi i fondit bibliotekar kontribuon në mënyrë të ndjeshme në sigurimin e literaturës bashkëkohore dhe në mbështetjen e drejtpërdrejtë të nevojave akademike të programeve të studimit, duke rritur cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Pasurimi i bibliotekës realizohet gjithashtu edhe përmes personelit kontributit të drejtpërdrejtë të akademik, i cili depoziton në bibliotekë tekste të reja mësimore, punime shkencore dhe cikle leksionesh. Kjo praktikë u konfirmua edhe gjatë vizitës së kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVJ) në ambientet e bibliotekës, ku u konstatua prania e materialeve të hartuara nga stafi akademik, të cilat i shërbejnë drejtpërdrejt mbështetjes së procesit mësimor dhe kërkimor. <i>Evidenca 2.40: Buxheti FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 4.10: Tekste mësimore të miratuara për programin "Master në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"</i> <i>Evidenca 4.14: Raportime mbi gjëndjen e fondit fizik të Bibliotekës FSHN, UT.</i>			
Konkluzione	Institucioni dispononte një bibliotekë me ambiente të bollshme, e cila ishte e pajisur me një numër të konsiderueshëm librash, revistash shkencore dhe publikimesh akademike, duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nevojat mësimore dhe kërkimore të studentëve dhe stafit akademik. Fondi i bibliotekës pasurohej rregullisht si nga Universiteti dhe nga personeli akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me	Administrimi i informacionit studentor realizohet përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Karrierës. Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) përdor sistemin e unifikuar digjital Microsoft Teams. Zbatimi i këtyre platformave kontribuon në rritjen e transparencës, saktësisë



studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	dhe koherencës në menaxhimin e ciklit të plotë të jetës studentore, duke përmirësuar ndërveprimin ndërmjet studentëve dhe administratës akademike, si dhe duke lehtësuar proceset e komunikimit dhe organizimit institucional. <i>Evidenca 3.3. Manual për përdorimin e platformës Microsoft teams.</i> <i>Evidenca 4.16: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Administrimi i të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Të gjitha informacionet ruhen në dosje personale të strukturuar, të cilat përfshijnë: kontratat e punës, dokumentacionin e trajnimeve të ndjekura, aktivitetin kërkimor-shkencor, si dhe publikimet akademike. Ky sistem dokumentimi siguron gjurmueshmëri, transparencë dhe menaxhim të efektshëm të burimeve njerëzore. Përdorimi i domainit emër. mbiemër@fshn.edu.al dhe emër.mbiemër@unitr.al garanton një lidhje të sigurt elektronike duke mundësuar një akses të lehtë dhe të sigurt në informacionin.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka ngritur një sistem elektronik komunikimi, i cili garanton një ndërlidhje efektive midis personelit akademik dhe studentëve. Për të lehtësuar përdorimin dhe funksionimin e këtij sistemi, Departamenti i Bioteknologjisë ka hartuar një manual përdorimi, i cili udhëzon përdoruesit në mënyrë të qartë dhe praktike. Përdorimi i këtij sistemi kontribuon në rritjen e cilësisë së veprimtarive akademike, përmirëson komunikimin institucional dhe rrit transparencën në procesin e vlerësimit të studentëve. <i>Evidenca 4.15: Rregullore e sekretaries mësimore.</i> <i>Evidenca 4.18: Sistemi e-student Manual përdorimi.</i> <i>Evidenca 4.19: Sistemi e-student Manual përdorimi për stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Komunikimi interaktiv me studentët realizohet kryesisht përmes platformës “Microsoft Teams”, e cila mundëson shkëmbim efektiv të informacionit në kohë reale. Përmes kësaj platforme, studentët informohen rregullisht mbi oraret e leksioneve, seminareve, praktikave, si dhe për datat e provimeve apo çdo ndryshim të rëndësishëm në programin mësimor. Përveç kësaj, përdoren dhe rrjetet sociale si kanale alternative komunikimi, duke

	lehtësuar shpërndarjen e informacionit dhe rritur aksesin e studentëve ndaj njoftimeve institucionale.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Përdorimi i platformave të sipërpërmendura shoqërohet me monitorim të vazhdueshëm të funksionimit të sistemit të komunikimit, duke garantuar efikasitet dhe akses të qëndrueshëm në çdo moment. Këto mjete moderne të komunikimit kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e ndërveprimit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, si dhe rrisin përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor dhe akademik.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) ishte funksionale në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht, duke ofruar akses të gjerë për përdorues të ndryshëm. Ajo përditësohej rregullisht, duke u ofruar studentëve dhe publikut informacion të detajuar në lidhje me programet e studimit, oraret e лекsioneve dhe praktikave, datat e provimeve, njoftimet akademike, si dhe mundësi të tjera që lidhen me jetën studentore dhe zhvillimet institucionale. <i>Megjithatë, evidentohet se informacionet dhe komunikimet publike që lidhen me bashkëpunimet me sektorin privat dhe industrinë bioteknologjike janë ende të kufizuara. Kjo tregon nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me aktorët e jashtëm, përfshirë institucionet kërkimore private dhe kompanitë farmaceutike e bioteknologjike, me qëllim rritjen e ndërveprimit praktik dhe aplikativ të programit në tregun real të punës.</i>			
Konkluzione	<i>Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar, me përfshirje në kërkime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Marrëveshjet me universitete dhe institucione kërkimore të huaja ofrojnë mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi për stafin akademik dhe studentët.</i> <i>Megjithatë, partneritetet me sektorin privat mbeten të kufizuara, sidomos në fushat e bioteknologjisë industriale dhe farmaceutike. Kjo kufizon mundësitë për praktika profesionale të zgjeruara dhe për aplikimin e drejtpërdrejtë të rezultateve të kërkimit në industri. Standardi përmbushet kryesisht, duke marrë parasysh cilësinë dhe angazhimin e stafit akademik dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, por me kufizime në lidhje me përfshirjen e sektorit privat në zhvillimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




			X	
--	--	--	---	--


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti i miratuar për periudhën 2021-2024 siguron mbështetjen e nevojshme financiare për funksionimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimeve Master gjatë gjithë ciklit akademik. Tarifat e shkollimit, të aplikuara në këtë program, janë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke garantuar transparencë, barazi në akses dhe respektim të standardeve të arsimit të lartë publik. <i>Evidenca 2.40: Buxheti i FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 2.42 Planifikimi buxheti i Departamentit të Bioteknologjisë 2021-2022-2023-2024.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Buxheti i programit të studimeve Master miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, në përputhje me rregulloret institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Ky buxhet parashikon në mënyrë të detajuar të gjitha nevojat e programit, duke përfshirë: furnizimet me materiale laboratorike, reagentë, pajisje didaktike dhe materiale zyre, të domosdoshme për realizimin cilësor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore. <i>Evidenca 2.40: Buxheti i FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 2.42 Planifikimi buxheti i Departamentit të Bioteknologjisë 2021-2022-2023-2024.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) i nënshtrohet në mënyrë të rregullt proceseve të auditimit të jashtëm, të kryera nga Ministria




dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	e Arsimit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të arsimit të lartë. Menaxhimi transparent dhe i përgjegjshëm i fondeve garanton zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimeve, duke krijuar kushte të favorshme për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe nxitjen e kërkimit shkencor brenda institucionit. <i>Evidenca 4.20: Urdhër Nr. 8 datë 30/03/2021 "Mbi miratimin e programit të Transparencës së Rishikuar në UT"</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raporti financiar, i përgatitur nga Universiteti në përfundim të çdo viti kalendarik, ofron një informacion të detajuar mbi realizimin e shpenzimeve, të klasifikuara sipas zërave të ndryshëm buxhetorë. Ky raport kontribuon në rritjen e transparencës financiare dhe në mbikëqyrjen efektive të përdorimit të fondeve publike, në funksion të qëllimeve akademike dhe kërkimore të institucionit. Të dhënat e raportit përdoren gjithashtu për planifikimin e buxhetit të viteve pasuese, duke u bazuar në analizën e trendeve të shpenzimeve dhe prioriteteve institucionale. <i>Evidenca 4.22: Plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara.</i> <i>Evidenca 4.23: Vendimi Nr. 56 datë 20/11/2019 "Për miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 për Universitetin e Tiranës."</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Gjatë viteve të fundit, institucioni ka dëshmuar një qëndrueshmëri të konsoliduar financiare, duke siguruar mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e vazhdueshëm të veprimtarive akademike, kërkimore dhe administrative. Garancia financiare mbështetet në disa burime kryesore të financimit, përfshirë: • Grantet e akorduara nga Ministria e Arsimit, • Të ardhurat nga tarifat e shkollimit, • të ardhurat e realizuara përmes ofrimit të shërbimeve për palë të treta, • Të ardhurat nga projekte kërkimore-shkencore. Këto burime të diversifikuara financimi sigurojnë qëndrueshmërinë ekonomike të institucionit, duke mbështetur realizimin dhe përmirësimin e veprimtarive akademike në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit.




	<i>Evidenca 2.40: Buxheti FSHN 2021-2024.</i> <i>Evidenca 4.24: Të ardhurat dhe finacimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit-Tabela 18 ASCAL</i> <i>Evidenca 4.25: Kostoja e programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ofron garanci për qëndrueshmëri financiare duke u mbështetur në burime të ndryshme financimi. Kjo shumëllojshmëri e burimeve financiare kontribuon në sigurimin e një baze të qëndrueshme për funksionimin dhe zhvillimin afatgjatë të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimeve Master funksionon në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi që rregullon procesin e regjistrimit të studentëve. Universiteti i Tiranës ka përcaktuar procedura të qarta dhe të strukturuar, të cilat bazohen në akte rregullative të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor. Programi përmban të detajuara të gjitha etapat dhe hapat që duhet të ndjekin kandidatët, me qëllim përmbushjen e kuotave dhe kriterëve të pranimi në studime. Të gjitha procedurat zbatohen në përputhje me udhëzimet vjetore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MARS), duke garantuar transparencë, barazi dhe përputhshmëri institucionale. <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, neni 14, pika 5, fq 8-9 dhe neni 31, gërma q, faqe 10-20.</i> <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, Neni 109, fq 19-20.</i>


	<i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale".</i> <i>Evidenca 1.25: Miratim kuotash në programin e studimit MSH në BMI.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVJ) si dhe në bashkëbisedimet e zhvilluara me studentët e programit, u konstatua se procedurat e zbatuara gjatë programit Master garantojnë respektimin e të drejtave të studentëve, si dhe barazinë e trajtimit përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Këto procedura sigurojnë përparim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë studentët, duke u shërbyer si mekanizëm mbështetës dhe lehtësues në realizimin me sukses të angazhimeve akademike gjatë programit të studimit. <i>Evidence 1.1: Statusi i UT, nenet 22, 23, fq 14-15.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale".</i> <i>Evidenca 5.1: Komisionet e UT.</i> <i>Evidenca 5.2: Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Çdo vit akademik, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) përcakton kuotat dhe kriteret e pranimit në programin Master, duke u mbështetur në kapacitetet pritëse akademike dhe laboratorike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). Kriteret e pranimit propozohen nga Departamenti i Bioteknologjisë, dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe më pas nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës (UT). Përzgjedhja e kandidatëve fitues bazohet në kriteret e përcaktuara në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret në fuqi të MARS dhe UT, duke garantuar transparencë dhe objektivitet në procesin e pranimit. Këto kriteret publikohen në kohë nga Departamenti i Bioteknologjisë dhe janë në përputhje me: • Ligjin Nr. 80/2015, neni 25, pika 8 • VKM Nr. 363, datë 26.05.2022, "Për një shtesë në vendimin nr. 436, datë 03.06.2020, 'Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë'" (Evidenca 5.7) • Udhëzimin e MAS, Nr. 12, datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e




	ciklit të parë të studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë” <i>Evidenca 5.7: VKM 363, datë 26.05.2022 “Për një shtesë mbi vendimin 436 të datës 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</i> <i>Evidenca 5.8: Udhëzimi i MAS, Nr 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve , në institucionet e arsimit të lartë.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit në programin Master janë të formuluar në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme për kandidatët, të cilëve u bëhen të ditura në përfundim të ciklit të parë të studimeve. Të gjitha informacionet përkatëse janë lehtësisht të aksesueshme dhe publikohen rregullisht në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, duke garantuar transparencë dhe qartësi për të gjithë aplikuesit. Po ashtu, procedurat dhe kriteret për regjistrim dhe transferim janë të përcaktuara qartë, duke u bazuar në parimin e njohjes dhe transferimit të krediteve të fituara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret institucionale në fuqi. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në Bioteknologjinë Molekulare dhe Industriale.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullorja e UT.</i> <i>Evidenca 5.9: Njoftim në faqen e FSHN, Ut mbi procedurat e njohjes së studimeve/trasferimit të studimeve, etj.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin Master bazohen në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, si dhe në rregulloren e brendshme të programit të studimit. Këto kriteret janë të publikuara në faqen zyrtare të programit dhe janë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë kandidatët e interesuar, duke garantuar një proces transparent, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikuesit. Zbatimi i këtyre kriterëve siguron përputhshmëri me standardet kombëtare të cilësisë dhe i shërben objektivit të përzgjedhjes së kandidatëve më të përshtatshëm për programin. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit “MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i>




	<i>Evidenca 1.4: Rregullorja e UT</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni zbaton një sërë kriteresh specifike për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe atyre që i përkasin shtresave të marginalizuara. Këto kritere miratohen nga Senati Akademik dhe synojnë të sigurojnë akses të barabartë dhe përfshirës në arsimin e lartë, në përputhje me parimet e barazisë dhe drejtësisë sociale. Këto masa synojnë të sigurojnë përfshirje të barabartë dhe akses të drejtë në arsimin e lartë për të gjithë kandidatët. <i>Evidenca 1.25: Miratim kuotash të studentëve në programin e studimit MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 1.26: Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit MSH në BMI.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret e pranimit si për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve shtetërorë, ashtu edhe për studentët e huaj. Këto kritere janë të publikuara në mënyrë transparente dhe zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me politikat institucionale për ndërkombëtarizim dhe përfshirje. Zbatimi i këtyre kriterëve synon të garantojë trajtim të barabartë, integrim akademik të plotë dhe promovim të diversitetit në procesin arsimor. <i>Evidenca 1.26: Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 5.10: Kriteret dhe kuotat e miratuara për Programin MSH në BMI për vitin akademik 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Programi Master parashikon bursa për studentët në nevojë ekonomike, si dhe reduktime të tarifave të shkollimit për studentët me arritje të larta akademike. Këto masa synojnë të nxisin dhe shpërblejnë ekselencën në studime, si dhe të mbështesin barazinë në aksesin ndaj arsimit të lartë. Nëpërmjet këtyre mekanizmave, institucioni kontribuon në krijimin e një mjedisi më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe motivues për të gjithë studentët, në përputhje me politikat sociale dhe arsimore të tij. <i>Evidenca 3.26: Lista e studentëve për bursë dhe reduktim tarife të programit MSH në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale.</i> <i>5.11: Vendimi nr 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave.</i>




Konkluzione	<i>Institucioni zbaton procedura të mirëpërcaktuara dhe funksionale për pranimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Këto procedura zhvillohen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe me rregulloret e brendshme institucionale, duke garantuar transparencë, barazi dhe koherencë në menaxhimin e ciklit të studimeve. Njëkohësisht, institucioni ofron bursa studimi, si për studentët në nevojë ekonomike, ashtu edhe për ata me rezultate të larta akademike, duke nxitur ekselencën dhe mbështetur përfshirjen sociale në arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik janë të bazuara në rregulloren akademike të institucionit dhe janë të publikuara në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), duke garantuar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë studentët. Gjatë takimeve të zhvilluara me studentët, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVJ) konstatoi se studentët zotëronin informacion të plotë në lidhje me kriteret e përparimit akademik, përfshirë numrin e krediteve për çdo lëndë, si dhe numrin minimal të krediteve të nevojshme për kalimin në vitin e dytë të programit Master. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 3.28: Rregullore e diplomimit të studentëve të ciklit të dytë të UT.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti zbaton një procedurë të qartë dhe të strukturuar për njohjen dhe transferimin e krediteve (ECTS), e cila përfshin kërkesat për dokumentacionin e nevojshëm, afatet kohore dhe hapësirat procedurale për realizimin e këtij procesi. Ky informacion i rëndësishëm u komunikohet studentëve në mënyrë të qartë dhe paraprakisht, veçanërisht në rastet e transferimit të studimeve në universitete të tjera, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij, në kuadër të programit Master. Procedura është në




	përputhje me kornizën ligjore të arsimit të lartë dhe standardet e Kartës së Bolonjës, duke garantuar koherencë akademike dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët. <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, nenet 108,109, fq 64.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimeve MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 5,9: Njoftim në faqen e FSHN mbi procedurat e njohje së studimeve, transferimeve etj.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në orën e parë mësimore, personeli akademik informon studentët në mënyrë të detajuar mbi format e vlerësimit, peshën përkatëse të secilës komponentë, si dhe afatet për përmbushjen e detyrimeve akademike. Ky informacion është gjithashtu i përcaktuar qartë në syllabus-in e çdo lënde, ku paraqitet metodologjia e vlerësimit që do të përdoret gjatë seminareve, praktikave mësimore dhe në provimin përfundimtar. <i>Evidenca 2.3: Syllabuset e disiplinave të MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 2.5: Struktura e vitit akademik 2021-2024.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët e programit Master janë të informuar që gjatë vitit të parë të studimeve mbi procedurat e hartimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. Gjatë këtij viti, çdo student përzgjedh udhëheqësin shkencor dhe temën përkatëse, në përputhje me fushën e studimit dhe objektivat e programit. Personeli akademik që udhëheq punimin e diplomës informon studentin mbi afatet zyrtare të dorëzimit të punimit shkencor si dhe mbi datat e mbrojtjes së diplomës. Këto procedura janë të sanksionuara në dokumentet rregullatore institucionale, të cilat përcaktojnë etapat, afatet dhe përgjegjësitë në procesin e diplomimit. <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, neni 89, fq 56.</i> <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 3.28: Rregullore e diplomimit të studentëve në ciklin e dytë të UT, Vendimi nr 12, datë 20.07.2022.</i> <i>Evidenca 5.13: Njoftim studentëve të programit MSH në BMI mbi dorëzimin dhe mbrojtjen e tezave të diplomimit.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe	Studentët marrin informacion të detajuar mbi programin e studimeve nëpërmjet sekretarisë mësimore, Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, si dhe faqes zyrtare të internetit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Gjithashtu, ish-studentët (alumni) të programit Master luajnë një rol të rëndësishëm në




organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	ndarjen e përvojës dhe informimin e brezave të rinj të studentëve. Një ndihmesë e veçantë në informim ofrohet edhe nëpërmjet aktiviteteve të tipit "Infoday", të cilat organizohen rregullisht nga Fakulteti, me synimin për të ofruar njohuri të detajuara mbi strukturën e programit Master, përmbajtjen e moduleve dhe mundësitë për kërkim shkencor në kuadër të Departamentit të Bioteknologjisë. <i>Evidenca 2.27.3: organizim takimi mbi ngritjen e rrjetit ALUMNI, FSHN, UT.</i> <i>Evidenca 2.22: "First EuroBiotech School-2019.</i> <i>Evidenca 2.23: "Second EuroBiotech School-2022.</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), garanton informimin e vazhdueshëm dhe të qartë të studentëve mbi: Kriteret e pranimit në programin e studimit; Detyrimet akademike dhe administrative që lidhen me vijimin e programit; Rregullat dhe afatet për përmbushjen e detyrimeve mësimore; Procedurat për mbrojtjen e provimit përfundimtar (tezës së diplomës); Kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve nga dhe drejt institucioneve të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë periudhës së regjistrimeve, kandidatët për studentët ju ofrohet një informacion i rëndësishëm në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Nga takimi me studentët GVJ arriti në konkluzion se studentët kishin të gjithë informacionin e detajuar mbi strukturën e programit të studimeve, kohëzgjatjen dhe organizimin dhe e tij. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimeve MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 1.22: Programi i Ciklit të dytë në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale.</i>

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Guida e fakultetit dhe programi mësimor shërbejnë si mënyrë efektive për informimin e studentëve. Në këto materiale studentëve u jepet në mënyrë të detajuar programit për secilën lëndë/modul dhe ngarkesa mësimore në auditor dhe jashtë tij. <i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimeve MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 1.22: Programi i Ciklit të dytë në Bioteknologji Molekulare dhe Industriale.</i> <i>Evidenca 5.14: Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Programi i studimit kishte realizuar një studim të tregut të punës dhe mundësitë e punësimit janë të larta si në sektorin shtetëror dhe atë privat. Një ndihmesë të theksuar në këtë drejtim japin dhe Zyra Alumni dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, të cilat ofrojnë cdo informacion në kohë reale për mundësitë e reja të punësimit që ofron tregu. <i>Evidenca 2.19: Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit në MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 2.50: Raporti i studimit të tregut të punës.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë mundësi të marrin informacionit përmes disa sistemeve ku bëjnë pjesë komunikimit elektronik përmes kontakteve direkte me personelin akademik të programit, Sekretarinë mësimore, Zyrën e Karrierës dhe faqes elektronike. Njëkohësisht cdo student ka akses në sistemit Ms Teams ku njoftohen për rezultatet e provimeve. <i>Evidenca 3.1: Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e mësimimit në distancë.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemet elektronike në dispozicion të FSHN mundësojnë komunikimin dhe edukimin dhe në distancë. Ky sistem është lehtësisht i aksesueshëm dhe garanton marrjen e informacionit përgjatë gjithë vitit duke shërbyer si urë komunikimi midis personelit akademik dhe studentëve. <i>Evidenca 3.1: Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e mësimimit në distancë.</i> <i>Evidenca 3.3: Manual për përdorimin e sistemit të mësimimit në distancë.</i>
Konkluzione	Programi master ofron metoda të ndryshme komunikimi për informimin e studentëve lidhur me funksionimin e programit të studimeve. Studentët e këtij programi kanë akses të vazhdueshëm

	në informacion përmes kanaleve elektronike, si dhe janë të integruar në një platformë të dedikuar për komunikim dhe informim të brendshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Programi Master i Shkencave në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” disponon evidenca dhe statistika të plota mbi numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik. Të dhënat janë të bazuara në: • Regjistrin themeltar të studentëve; • Regjistrin e arritjeve akademike të secilit student; • Regjistrin e lëshimit të diplomave. Këto evidenca ruhen dhe arkivohen në mënyrë të rregullt në sekretarinë mësimore, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe rregulloret përkatëse të Universitetit të Tiranës, duke garantuar gjurmueshmëri, transparencë dhe integritet të procesit të diplomimit. <i>Evidenca 3.35. Rregjistri themeltar të studentëve-demostrim.</i> <i>Evidenca 3.36. Rregjistrin e arritjeve akademike të studentit.</i> <i>Evidenca 3.37. Rregjistrin e lëshimit të diplomave.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) mban dhe përditëson në mënyrë të rregullt statistikën zyrtare për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimeve Master në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”. Këto të dhëna përpunohen dhe ruhen nga sekretaria mësimore, në regjistra të veçantë, duke respektuar formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Përmes përditësimit sistematik të këtyre statistikave, institucioni siguron monitorim të vazhdueshëm të ecurisë së

zhvillohet programi i studimeve.	programit dhe analizë për planifikim strategjik. Numri i studentëve të regjistruar përgjatë viteve akademike është si më poshtë: • Viti akademik 2021-2022 32 studentë • Viti akademik 2022-2023 30 studentë • Viti akademik 2023-2024 26 studentë • Viti akademik 2024-2025 38 studentë Ky trend reflekton dinamikën e kërkesës dhe kapaciteteve pritëse, duke shërbyer si bazë për vlerësime periodike të qëndrueshmërisë dhe atraktivitetit të programit. <i>Evidenca 4.15: Rregullore e sekretarisë mësimore.</i> <i>Vizita në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat e studentëve administrohen në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit të Universitetit të Tiranës. Administrimi përfshin regjistrimin në formë fizike (regjistra zyrtarë) si dhe në format elektronik, duke siguruar gjurmueshmëri, saktësi dhe transparencë në çdo fazë të ciklit të studimeve. Përveç dokumentimit tradicional, sistemi elektronik "e-Student" ofron akses në kohë reale për studentët, duke i informuar ata mbi: • Orarin e mësimit, • Detyrimet akademike, • Notat e provimeve, • Njoftime të tjera të rëndësishme. Ky sistem garanton ruajtjen, kontrollin dhe verifikimin e të dhënave, jo vetëm për qëllime të brendshme administrative, por edhe për monitorim nga ekspertë të jashtëm, në përputhje me standardet ligjore dhe rregullative për arsimin e lartë në Shqipëri. <i>Evidenca 4.18: Sistemi e-student Manual përdorimi.</i> <i>Evidenca 4.19: Sistemi e-student manual përdorimi stafi akademik.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të	Aktet e brendshme rregullative të institucionit garantojnë zhvillimin e kontrolleve periodike dhe të sistematizuara mbi dokumentacionin që lidhet me aktivitetin akademik të studentëve. Të dhënat e grumbulluara përfshihen në analizat akademike të Departamentit, si dhe në sistemet e brendshme të menaxhimit dhe






brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	vlerësimit të cilësisë, duke siguruar monitorim efektiv dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Evidencë 1.4: Rregullorja e UT, neni 14-20.</i> <i>Evidencë 3.19.1: Rregullore e veprimtarisë së DSBCK.</i> <i>Evidencë 4.15: Rregullore e sekretarisë mësimore.</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Programi Master realizon vlerësime periodike si pjesë të analizës kërkimore-shkencore, duke përfshirë raportin hyrje/dalje dhe nivelin e punësimit të të diplomuarve. Informacioni mbi punësimin mbështetet kryesisht në sistemin e gjurmimit të studentëve dhe Alumni. Megjithatë, identifikimi dhe gjurmimi i të diplomuarve që kanë emigruar jashtë vendit paraqet vështirësi të konsiderueshme. <i>Evidenca 5.19: Vendimi Nr 26, datë 21.10.2020 "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 5.20: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve gjatë viteve 2021-2024-Tabela 23 ASCAL.</i> <i>Evidenca 5.21: Procedura për matriculimin, lista fituese të rregjistruara në ciklin e dytë të studimeve.</i>			
Konkluzione	Departamenti i Bioteknologjisë menaxhon statistikën e studentëve përmes sistemeve të brendshme. Këto të dhëna tregojnë një rënie të lehtë në regjistrimet në programin Master gjatë periudhës 2023-2024. Në kuadër të kriterit 5, vlen të theksohet se bashkëpunimi me Zyrën Alumni ndihmon në plotësimin e informacionit mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Ligji për arsimin e lartë dhe Statuti i Universitetit të Tiranës garantojnë përfaqësimin dhe angazhimin aktiv të studentëve në struktura të ndryshme drejtuese institucionale, si Senati Akademik dhe Këshilli i Etikës. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës

në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	funksionon gjithashtu Këshilli Studentor, i cili mbron dhe promovon interesat e studentëve në raport me strukturat drejtuese të universitetit. <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT, neni 30.</i> <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT, neni 40.</i> <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT, neni 41.</i> <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT, neni 42.</i> <i>Evidenca 1.1 Statusi i UT, neni 43.</i> <i>Evidenca 5.1 Komisionet e UT.</i> <i>Evidenca 5.2 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejti se ata merrnin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisioneve të ndryshme të fakultetit. Studentët shprehën opinionet e tyre mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mënyrën e vlerësimit, përmes anketave anonime dhe bashkëbisedimeve me titullaren e departamentit. <i>Evidenca 2.27.1: Modeli i pyetësorit "Vlerësim i lëndës nga studenti."</i> <i>Evidenca 3.10: Vlerësimi i lëndës nga studentet Sem II, 2021-2022.</i> <i>Evidenca 5.24: Raport mbi pyetësorin "Vlerësim i programeve të studimit 2021-2024".</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Programi i studimeve Master parashikon përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit. Këto mekanizma funksionojnë në praktikë dhe kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. <i>Megjithatë, gjatë viteve të fundit nuk janë ndërmarrë ndryshime në kurrikulën e programit Master.</i> <i>Evidenca 1.4: Rregullorja e UT, neni 61, 62.</i> <i>Evidenca 2.29: Të dhëna për anëtarët e KPSSC dhe DSBCK.</i> <i>Evidenca 5.25: Raport mbi pyetësorin "Vlerësimi i programeve të studimit 2021-2024."</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të	Studentët gëzojnë të drejtën të shprehin opinionet e tyre për përmirësimet e mundshme të programit, veçanërisht në lidhje me procesin e vlerësimit. Programi i studimeve u njeh gjithashtu studentëve të drejtën e ankimimit, e cila është e përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse të programit. Ky proces ankimimi zhvillohet në disa hapa, duke filluar nga paraqitja e ankesës te Përgjegjësi i Departamentit dhe më pas te

rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Dekani, i cili brenda 48 orëve nga marrja e ankimimit ngre një komision ad-hoc për shqyrtimin e çështjes.			
Konkluzione	<i>Evidenca 1.21: Rregullorja e programit të studimit MSH në BMI.</i> <i>GVJ vërejtë se studentët janë të përfaqësuar në strukturat drejtuese të universitetit, dhe ky përfaqësim është i garantuar në mënyrë institucionale. Atyre u garantohen të gjitha mundësitë e nevojshme për rishikimin e vlerësimeve të provimit, kur mendojnë se rezultatet e marra janë poshtë pritshmërisë që kanë. Ky proces është i shprehur dhe në rregulloret e Universitetit por nuk është aplikuar asnjëherë deri më sot.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti i Bioteknologjisë ka ngritur struktura që mundësojnë informimin e studentëve lidhur me programin e studimeve, sezonin e provimeve dhe procesin e diplomimit. Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, përmes ambienteve të dedikuara, ka funksionuar në mënyrë të plotë për të garantuar informim të detajuar për studentët. Në të njëjtën kohë, çdo grup mësimor kishte një kujdestar akademik, i cili shërbente si urë lidhëse midis studentëve, personelit akademik dhe sekretarive. <i>Evidenca 1.1: Statusi i UT, Neni 127, fq 70.</i> <i>Evidenca 1.27: Lista e tutorëve për secilin vit të MSH në BMI</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Procesi i informimit në programin Master realizohet përmes strukturave të dedikuara, të cilat përfshijnë Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës. Në mbështetje të këtyre strukturave është edhe personeli akademik, i cili, në fillim të çdo viti akademik, informon studentët mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe ndjek përparimin individual të secilit student.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit dhe Karrierës ka si funksion parësor informimin dhe orientimin e studentëve gjatë gjithë vitit akademik. Ajo udhëzon studentët në lidhje me realizimin e praktikës profesionale dhe njëkohësisht shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe sektorit privat, me qëllim orientimin e tyre drejt tregut të punës. <i>Evidenca 3.19: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i> <i>Evidenca 5.27: Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, UT, viti akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës harton raporte analitike me fokus punësimin e studentëve të programit Master. Përditësimi vjetor i këtyre raporteve ndihmon në krijimin e një pamje më të qartë mbi mundësitë profesionale që u ofrohen studentëve pas diplomimit. Njëkohësisht, kjo zyrë ofron mundësi konkrete punësimi për studentët, duke lehtësuar kalimin e tyre drejt tregut të punës. <i>Evidenca 2.19: Raporti përmbledhës i gjurmimit të studentëve pas diplomimit në MSH në BMI.</i> <i>Evidenca 2.27.2 Tabelë përmbledhëse e gjurmimit të studentëve që punësohen, FSHN, UT</i> <i>Evidenca 2.31: Raporti i studimit të tregut të punës në UT.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ofron një kuadër të plotë rregullash dhe strukturash për mbështetjen e studentëve gjatë procesit të studimeve dhe diplomimit. Procedurat për detyrimet përmbyllëse janë të qarta dhe të publikuara, tutorët e përcaktuar ofrojnë udhëzime dhe konsulta sipas nevojave të studentëve, ndërsa kalendari i sezoneve të diplomimit është i përcaktuar dhe i publikuar rregullisht. Studentët mbështeten gjatë përzgjedhjes dhe zhvillimit të tezës së diplomës, kanë akses në laboratorë dhe pajisje kërkimore, si dhe asistencë nga personeli akademik për përpunimin e rezultateve dhe shkrimin e punimit. Proceset e vlerësimit dhe dokumentimit të rezultateve përfundimtare janë transparente dhe të standardizuara, ndërsa diplomimi dhe suplementi i diplomës lëshohen në përputhje me kuadrin ligjor.</i>




	Megjithatë, mbështetja e studentëve është e përqendruar kryesisht në fazën e studimeve dhe të diplomimit. Institucioni nuk ka të formalizuar një sistem të qëndrueshëm për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve dhe për integrimin e feedback-ut të tyre dhe të punëdhënësve në zhvillimin e mëtejshëm të programit. Kjo dobësi e kufizon përdorimin e informacionit mbi punësueshmërinë dhe suksesin profesional të të diplomuarve si bazë për përmirësimin dinamik të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve me stafin, konstaton se Universiteti i Tiranës ka ndërmarrë hapa të qartë për garantimin e cilësisë së mësimdhënies përmes hartimit të udhëzuesve dhe manualeve që lidhen me përdorimin e metodave inovative dhe mësimdhënien online. Evidencat e paraqitura tregojnë jo vetëm përshtatshmërinë e UT në situata të veçanta si pandemia COVID-19, por edhe vëmendjen e vazhdueshme ndaj trajnimit të stafit akademik dhe përshtatjes së metodave të mësimdhënies me kërkesat bashkëkohore. Ky angazhim siguron jo vetëm vazhdimësinë e proceseve mësimore, por edhe rritjen e cilësisë së përvojës së studentëve në përputhje me standardet ndërkombëtare. <i>Evidenca 3.1 – Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie</i>

	<i>Evidenca 3.2 – Manual për zhvillimin e mësimdhënies online në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 3.3 – Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Gjatë vizitës u konstatua se Universiteti i Tiranës ka ngritur dhe funksionalizuar mekanizma të qartë për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik dhe ndihmës-akademik. Ky proces bazohet në plane strategjike dhe rregullore institucionale, të mbështetura nga instrumente si Paketa e instrumenteve të cilësisë dhe Manuali i cilësisë. Në nivel fakulteti, DSBCK është struktura përgjegjëse që siguron zbatimin e mekanizmave të monitorimit. Është vlerësuar pozitivisht përdorimi i pyetësorëve për vlerësimin e lëndëve nga studentët, si dhe përfshirja e mekanizmave të vetëvlerësimit nga pedagogët, të cilat ofrojnë një pamje gjithëpërfshirëse mbi cilësinë e mësimdhënies dhe elementët inovativë të saj. Nga analiza e evidencave dhe diskutimet gjatë vizitës, rezultojnë se UT ka një praktikë të konsoliduar të monitorimit, e cila mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe adresimin e problematikave në mënyrë të strukturuar. <i>Evidenca 6.1 – Plani Strategjik i Universitetit të Tiranës për garantimin e cilësisë së mësimdhënies</i> <i>Evidenca 3.19 – Rregullore për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe ndihmës-akademik</i> <i>Evidenca 3.16 – Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 6.2 – Manuali i cilësisë së Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 3.18 – Dokument mbi funksionimin e DSBCK-së në nivel fakulteti</i> <i>Evidenca 3.8 – Pyetësor për vlerësimin e lëndës nga studentët (model)</i> <i>Evidenca 3.9 – Përmbledhje e rezultateve të pyetësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 3.10 – Analizë e rezultateve të pyetësorëve për vitin akademik përkatës</i> <i>Evidenca 3.11 – Raport përmbledhës mbi vlerësimin e lëndëve nga studentët</i> <i>Evidenca 2.27.1 – Pyetësor i studentëve për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve</i> <i>Evidenca 5.25 – Analizë krahasuese e vlerësimeve të studentëve</i>




	<i>për periudha të ndryshme</i> <i>Evidenca 3.12 – Vetëvlerësim i pedagogëve mbi mësimdhënien dhe inovacionin pedagogjik</i> <i>Evidenca 5.26 – Raport përmbledhës mbi rezultatet e vetëvlerësimit të stafit akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Gjatë vizitës u konstatua se Universiteti i Tiranës siguron përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe të metodave të saj, përfshirë edhe procesin e trajtimit të ankimimeve. Studentët e FSHN dhe UT marrin pjesë në monitorimin e cilësisë përmes pyetësorëve në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti përmes tutoratit. Procedurat e ankimimit dhe zgjidhjes së problemeve janë të qarta dhe të detajuara në rregulloren e UT, ndërsa studentët janë të përfshirë edhe në strukturat që monitorojnë dhe vlerësojnë formën dhe cilësinë e mësimdhënies, përfshirë KPSSC dhe DSBCK. Kjo praktikë garanton që studentët të kenë një rol aktiv në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve akademike. <i>Evidenca 3.8 – Pyetësor për vlerësimin e lëndës nga studentët (model)</i> <i>Evidenca 3.9 – Përmbledhje e rezultateve të pyetësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 3.10 – Analizë e rezultateve të pyetësorëve për vitin akademik përkatës</i> <i>Evidenca 3.11 – Raport përmbledhës mbi vlerësimin e lëndëve nga studentët</i> <i>Evidenca 2.27.1 – Pyetësor i studentëve për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve</i> <i>Evidenca 5.25 – Analizë krahasuese e vlerësimeve të studentëve për periudha të ndryshme</i> <i>Evidenca 1.27 – Raport mbi funksionimin e sistemit të tutoratit në Departamentin e Bioteknologjisë</i> <i>Evidenca 1.4 – Rregullore e Universitetit të Tiranës, nenet 61 dhe 62 mbi procedurat e ankimimit</i> <i>Evidenca 2.29 – Dokument mbi funksionimin e KPSSC dhe DSBCK në monitorimin e cilësisë së mësimdhënies</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	Gjatë vizitës u vërejt se FSHN, UT bën publike rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies duke i analizuar ato në mbledhjet e departamenteve dhe dekanatit. Stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët informohen rregullisht për gjetjet

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	e monitorimeve përmes publikimeve online, duke respektuar ligjin Nr. 9887, të shfuqizuar me Ligjin Nr. 48/2012 për mbrojtjen e të dhënave. Raportimet vjetore përdoren si një mjet transparent për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të programeve të studimit, duke kontribuar në ndërgjegjësimin dhe angazhimin e të gjithë aktorëve akademikë. Ky mekanizëm siguron një qasje të hapur dhe të sistematizuar për ndarjen e rezultateve të vlerësimit, duke përmirësuar transparencën dhe cilësinë e procesit mësimor. <i>Evidenca 5.27 – Raport Vjetor për vlerësimin e programeve në FSHN, UT, viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca 5.29 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, viti akademik 2022-2023</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	FSHN, UT promovon praktika të mira mësimore dhe nxit përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Rezultatet e raportuara nga DSBCK në nivel fakulteti janë të organizuara në mënyrë grafike për të lehtësuar interpretimin dhe përdorimin e tyre. Praktikrat më pozitive shpërndahen dhe diskutohen në mbledhjet e departamenteve dhe fakultetit, duke inkurajuar stafin akademik të adoptojë qasje efektive në mësimdhënie. Ky proces dokumentohet rregullisht në raportet vjetore të FSHN, UT, duke siguruar një qasje të strukturuar dhe transparente për promovimin e shembujve të praktikave të mira në mësimdhënie. <i>Evidenca 1.28 – Raportet vjetore të FSHN, UT, 2021-2024</i> <i>Evidenca 5.27 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve, 2021-2022</i> <i>Evidenca 5.28 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve, 2022-2023</i> <i>Evidenca 5.29 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve, 2023-2024</i>
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se Universiteti i Tiranës ndjek një politikë të qartë dhe të konsoliduar për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke hartuar udhëzues dhe mekanizma të strukturuar për zhvillimin e metodave inovative dhe monitorimin e proceseve mësimore. Ky angazhim siguron përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve, transparencë në raportim dhe promovim të praktikave të mira, duke rritur</i>





	<i>vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies në përputhje me standardet ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës ka krijuar politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe me rregulloret institucionale. Senati Akademik ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe procedurat për zbatimin e tij, ndërsa janë ngritur strukturat përgjegjëse në nivel institucioni, përfshirë KPSSC, Komisionin e Kurrikulës dhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore. Në nivel fakulteti, DSBCK luan rolin e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke organizuar pyetësorët studentorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe duke hartuar raportet përkatëse. Ky sistem i strukturuar garanton monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e proceseve akademike dhe kërkimore në njësitë përkatëse. <i>Evidenca 3.14 – Politikat institucionale për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 6.1 – Manuali i Sigurimit të Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik</i> <i>Evidenca 3.19 – Procedurat për zbatimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 3.16 – Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 6.2 – Udhëzuesi për zbatimin e mekanizmave të cilësisë</i> <i>Evidenca 5.1 – Vendim i Senatit Akademik për ngritjen e strukturave të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.1, nenet 140–141 – Përcaktimet statutores për strukturat e Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca 3.18 – Raport mbi funksionimin e DSBCK</i>

	<i>Evidenca 3.8–3.12 – Pyetësorët dhe raportet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies</i> <i>Evidenca 2.27.1 – Pyetësi studentor për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve</i> <i>Evidenca 5.25 – Analizë e rezultateve të pyetësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 5.26 – Vetëvlerësim i pedagogëve mbi cilësinë e mësimdhënies</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti i Tiranës ka ngritur dhe mban funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBC), duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është përgjegjës për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, dhe përbëhet nga anëtarë të stafit akademik dhe student. Në nivel fakulteti, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) luan rol kyç në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Kjo degë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësive kryesore, funksionon mbi bazën e rregullore së posaçme dhe është e lidhur me Dekanin e FSHN. Veprimtaria e DSBCK mbështetet në rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës dhe në instrumentet e cilësisë të miratuara nga Senati Akademik. Ky mekanizëm siguron një qasje të strukturuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha njësitë akademike. <i>Evidenca 5.1 – Vendim i Senatit Akademik për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC)</i> <i>Evidenca 2.29 – Dokument mbi përbërjen dhe funksionimin e KPSSC dhe DSBCK</i> <i>Evidenca 3.18 – Raport mbi funksionimin e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK)</i> <i>Evidenca 3.19.1 – Rregullore e posaçme për funksionimin e DSBCK në FSHN</i> <i>Evidenca 3.19 – Procedura institucionale për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 3.16 – Paketa e instrumenteve të cilësisë të miratuara nga Senati Akademik</i>

	<i>Evidenca 6.1 – Manuali i Sigurimit të Cilësisë i Universitetit të Tiranës</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës përdor instrumente dhe tregues të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë, duke kombinuar proceset e sigurimit të brendshëm me ato të jashtëm. Sigurimi i jashtëm realizohet përmes akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, sipas detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 104 të LAL Nr. 80/2015. Procesi i akreditimit institucional të UT përfundoi me vlerësim pozitiv dhe akreditim për 4 vite akademike, duke konfirmuar përmbushjen e standardeve shqiptare të cilësisë. Për sigurimin e brendshëm, DSBCK në FSHN bashkëpunon me njësitë bazë për të zbatuar instrumentet e vlerësimit të përcaktuara nga Paketa e instrumentave të cilësisë. Studentët janë aktivisht të përfshirë në plotësimin e pyetësorëve/formularëve për vlerësimin e lëndëve dhe programeve të studimit, ndërsa UT përdor analizën e rezultateve dhe raporte vjetore për të identifikuar mundësi për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm. Ky kombinim i mekanizmave të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm tregon një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike për garantimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në UT. <i>Evidenca 2.11 – Raport mbi akreditimin institucional të Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 2.12 – Raport mbi akreditimin e programeve të studimit të Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 3.16 – Paketa e instrumenteve të cilësisë të miratuara nga Senati Akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës, përmes DSBCK në FSHN, përdor tregues të qartë dhe instrumente të matshme për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë në mësimdhënie dhe kërkim. Pyetësorët e përvitshëm për studentët, pedagogët dhe diplomantët (<i>Evidenca 3.8; Evidenca 3.12; Evidenca 2.27; Evidenca 5.26</i>) sigurojnë një pasqyrë të plotë të ecurisë së programeve të studimit, ndërsa rezultatet shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike. Procesi mbështetet nga Manuali i Cilësisë, Rregullorja dhe Paketa e Instrumentave të miratuara nga Senati Akademik (<i>Evidenca 6.3</i>), duke garantuar standardizim dhe unifikim të instrumenteve të vlerësimit. Ky mekanizëm lejon identifikimin e praktikave të mira dhe promovimin e arritjeve më të shkëlqyera në mësimdhënie, duke kontribuar në një sistem të qëndrueshëm dhe transparent të sigurimit të cilësisë.

Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës ka struktura, politika dhe procedura të qarta dhe funksionale për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me ligjin dhe rregulloret institucionale. Sistemi institucional dhe fakultetar, përmes KPSSC dhe DSBCK, garanton mbikëqyrje dhe vlerësim të vazhdueshëm të cilësisë.</i> <i>Përdorimi i instrumenteve të matshme dhe pyetësorëve për studentët, pedagogët dhe diplomantët lejon identifikimin e dobësive dhe promovimin e praktikave më të mira. Ky sistem tregon një qasje të qëndrueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe	Gjatë vizitës së fushës, u konstatuan mekanizma të qartë, formalë dhe të dokumentuar për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit në Universitetin e Tiranës. Raportet vjetore të nivelit institucional, fakultetar dhe departamental demonstrojnë një sistem të strukturuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e programeve, duke evidentuar arritjet, dobësitë dhe masat për përmirësim. Procedurat për ndryshime në programin e studimit janë të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe në rregullore institucionale të miratuara, duke garantuar transparencë dhe standardizim. Njësitë për sigurimin e cilësisë, veçanërisht DSBCK në FSHN, zbatojnë pyetësorë të standardizuar për studentët, pedagogët dhe diplomantët, të cilët përdoren për të reflektuar mbi ecurinë e programeve dhe për të orientuar përmirësimet. Në bazë të diskutimeve dhe materialeve të paraqitura gjatë vizitës, u vlerësua se ky proces siguron një qasje të vazhdueshme, të standardizuar dhe transparente për monitorimin e programeve të studimit të ciklit të dytë. Përfshirja e DSBCK, mbështetur nga Manuali i Cilësisë, Rregullorja dhe Paketa e Instrumentave të

vendimmarrëse për programin e studimit.	miratuara nga Senati Akademik, garanton që vendimmarrja të bazohet në të dhëna objektive dhe të përditësuara.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Departamenti i Bioteknologjisë harton dhe publikojnë raportet vjetore mbi veprimtarinë akademike dhe programet e studimit për vitet akademike 2021–2024. Këto raporte përdoren më tej në nivel fakulteti dhe përfshijnë: • Rezultatet e pritshme dhe ato reale të programeve; • Vlerësimin e mbarëvajtjes së programeve dhe identifikimin e dobësive; • Motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira; • Masat e marra për përmirësimin e cilësisë dhe adresimin e mangësive; Tregues të matshëm, përfshirë: numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, studentë të shkëlqyer, përmbushjen e standardeve të stafit akademik (<i>artikuj të botuar, pjesëmarrje në konferenca, projekte</i>), përmirësimin e strukturës laboratorike dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik. Pyetësorët e përvitshëm të DSBCK plotësojnë këtë proces, duke siguruar një pasqyrë të plotë të performancës akademike dhe promovimin e arritjeve më të mira nga stafi akademik dhe studentët. Raportet vjetore bëhen të njohura dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të FSHN, duke garantuar transparencë dhe qasje për autoritetet dhe vendimmarrësit. Procesi i dokumentuar dhe i integruar i raportimit dhe përdorimit të rezultateve të vlerësimit tregon një mekanizëm të mirëfunksionuar për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, duke respektuar standardet e arsimit të lartë dhe duke promovuar arritjet më të mira në mësim dhe kërkim. <i>Evidenca 5.19 – Raport Vjetor Institucional për monitorimin e programeve të studimit në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 1.28 – Raportet Vjetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), UT, për vitet akademike 2021–2024</i> <i>Evidenca 1.37 – Raportet Vjetore të Departamentit të Bioteknologjisë për vitet akademike 2021–2024</i> <i>Evidenca 6.4 – Procedura për miratimin e ndryshimeve në programet e studimit</i> <i>Evidenca 3.8 – Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët</i> <i>Evidenca 5.25 – Analiza e rezultateve të pyetësorëve të studentëve</i>

	<i>për vlerësimin e lëndëve</i> <i>Evidenca 2.27 – Raporti përmbledhës i feedback-ut të studentëve dhe diplomantëve</i> <i>Evidenca 5.26 – Vetëvlerësim i pedagogëve mbi cilësinë e mësimdhënies</i> <i>Evidenca 6.3 – Manuali i Cilësisë i miratuar nga Senati Akademik i UT</i> <i>Evidenca 3.12 – Vetëvlerësim i stafit akademik në procesin e sigurimit të cilësisë</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	FSHN dhe Njësitë Bazë përdorin metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përfshirë mësimdhënien, didaktikën, kurrikulën, provimet dhe vëzhgimet laboratorike. Procedurat janë të strukturuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar monitorim të qëndrueshëm të cilësisë dhe promovim të performancës së lartë akademike, përfshirë motivimin e arritjeve më të mira nga stafi akademik dhe studentët. Çdo vit akademik hartohen raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, ndërkohë që DSBCK realizon pyetësorët për studentët dhe pedagogët dhe harton analizat përkatëse. Raportet vjetore mbi cilësinë e programeve përdoren për adresimin e dobësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, duke garantuar një vlerësim të standardizuar dhe gjithëpërfshirës. <i>Evidenca 1.28 – Raportet Vjetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), UT, për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore</i> <i>Evidenca 3.9 – Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët</i> <i>Evidenca 3.10 – Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së lëndëve</i> <i>Evidenca 3.11 – Pyetësor për vlerësimin e pedagogëve</i> <i>Evidenca 5.25 – Analiza e rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e lëndëve</i> <i>Evidenca 5.26 – Vetëvlerësim i pedagogëve mbi cilësinë e mësimdhënies</i> <i>Evidenca 5.27 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, 2021–2022</i> <i>Evidenca 5.28 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, 2022–2023</i> <i>Evidenca 5.29 – Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, 2023–2024</i>






Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	FSHN/Departamenti i Bioteknologjisë përdor metoda dhe instrumente të tërthorta për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit, përfshirë sondazhe dhe intervista me studentët, alumni, personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe punëdhënësit e institucioneve bashkëpunuese. Gjatë sezonit të diplomimit, studentët e programit MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” japin vlerësimin e tyre kritik për programin nëpërmjet pyetësorit “Vlerësimi i studentëve që diplomohen”, ndërsa mendimi i studentëve aktivë merret përmes përfaqësuesve në Komisionin e Kurrikulës dhe Grupet e Vlerësimit të Brendshëm. Gjithashtu, personeli akademik realizon vetëvlerësimin e lëndëve që mbikëqyr, bazuar në përqindjen e kalueshmërisë dhe shpërndarjen e notave, dhe jep mendimin kritik mbi përmirësimet e nevojshme në përputhje me standardet e ASCAL. Këto instrumente të tërthorta sigurojnë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe transparent, duke garantuar monitorim të qëndrueshëm të cilësisë dhe promovim të performancës së lartë akademike, përfshirë motivimin e arritjeve më të mira nga stafi akademik dhe studentët. <i>Evidenca 2.27 – Raporti përmbledhës i vlerësimit të studentëve që diplomohen në programin MSH në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”</i> <i>Evidenca 2.31 – Raport mbi intervistat dhe sondazhet me alumni dhe punëdhënësit e institucioneve bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 2.29 – Raport mbi përfaqësimin e studentëve dhe partnerëve në strukturat e sigurimit të cilësisë (KPSSC, DSBCK)</i> <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, neni mbi përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese</i> <i>Evidenca 2.30 – Raport mbi pjesëmarrjen e studentëve në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB)</i> <i>Evidenca 5.24 – Raport mbi përfshirjen e studentëve aktivë në proceset e vlerësimit të programeve</i> <i>Evidenca 5.26 – Vetëvlerësim i pedagogëve mbi cilësinë e mësimdhënies dhe rezultatet e lëndëve</i>
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka vendosur një sistem të strukturuar, të dokumentuar dhe transparent për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit. Procedurat e integruara, përfshirë vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe tërthortë, raportimet vjetore, pyetësorët për studentët dhe pedagogët, si dhe përdorimin</i>





	e statistikave dhe analizave të punësimit, sigurojnë një monitorim të qëndrueshëm të cilësisë. Ky sistem garanton arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit, promovon performancën e lartë akademike dhe orienton masat për përmirësim të vazhdueshëm, duke përfshirë motivimin e arritjeve më të mira nga stafi akademik dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti i Tiranës parashikon dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Neni 7 i Statutit të UT-së thekson se, përmes autonomisë akademike dhe financiare, universiteti lidh marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas dhe të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore dhe inovative, duke mundësuar kështu përfshirjen aktive të aktorëve të interesuar. Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT ka përcaktuar politika dhe procedura të qarta, duke kryer vlerësime periodike për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Statuti (nenet 138–141) dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë përcaktojnë procedurat, instrumentat, afatet dhe burimet për zbatimin e këtij procesi, duke garantuar një qasje sistematike dhe transparente në menaxhimin e cilësisë akademike. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 7 dhe nenet 138–141 mbi autonominë dhe sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 3.14 – Politikat institucionale të Universitetit të Tiranës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 3.19 – Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës, përfshirë procedurat, instrumentat dhe afatet për vlerësimin periodik të programeve të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	Universiteti i Tiranës përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, personelin, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në

detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces përmes përfaqësimit të tyre në komisione dhe struktura të brendshme të universitetit. Konkretisht: • Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përfshin 3 përfaqësues të studentëve. • Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës ka 2 përfaqësues studentësh. • Studentët angazhohen gjithashtu në vlerësimin e programeve akademike dhe në vlerësimin institucional përmes Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Ky model garanton ushtrimin me përgjegjësi të detyrave të përcaktuara dhe siguron që zëri i studentëve të jetë pjesë e vendimmarrjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. <i>Evidenca 1.1 – Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 40 dhe neni 42 mbi përfaqësimin e studentëve në komisionet e brendshme institucionale</i> <i>Evidenca 5.1 – Vendimi për përbërjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 2.30 – Raport mbi përfshirjen e studentëve në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB)</i> <i>Evidenca 5.24 – Raport mbi angazhimin e studentëve në procesin e vlerësimit të programeve të studimit</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	FSHN garanton përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, si dhe studentëve në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Përfaqësimi institucional realizohet përmes: • Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës, ku FSHN ka përfaqësuesit e saj. • Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), si Njësi Kryesore e sigurimit të cilësisë për programet e ciklit të parë dhe të dytë. • Studentëve, të cilët kontribuojnë nëpërmjet anketimeve periodike nga DSBCK, marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli Studentor, si dhe takimeve me Kujdestarët e programit.

	Ky mekanizëm siguron që të gjithë aktorët kyç të përfshihen në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. <i>Evidenca 2.29 – Raport mbi përfaqësimin e FSHN në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës</i> <i>Evidenca 5.1 – Vendimi i Senatit Akademik për përbërjen dhe funksionimin e KPSSC në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 1.17 – Dokument mbi funksionimin e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) si njësi kryesore për sigurimin e cilësisë në FSHN</i> <i>Evidenca 3.9–3.11 – Pyetësorët vjetorë të realizuar nga DSBCK për studentët, personelin akademik dhe administrativ</i> <i>Evidenca 5.25 – Raporti përmbledhës i analizës së rezultateve të pyetësorëve të DSBCK</i> <i>Evidenca 1.28 – Raporti Vjetor i FSHN mbi përfshirjen e studentëve dhe rezultate e vlerësimit të programeve të studimit</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë proceseve ciklike të vlerësimit të programeve të studimit, përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm realizohet duke respektuar plotësisht integritetin akademik, parimet etike dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (<i>Ligji Nr. 9887/2008, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012</i>). Vlerësimi nga studentët dhe personeli akademik kryhet në mënyrë anonime dhe konfidenciale, duke siguruar një proces të drejtë, pa diskriminim apo pabarazi. DSBCK dhe strukturat përkatëse mbikëqyrin respektimin e këtyre standardeve gjatë gjithë procesit të sigurimit të cilësisë.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Si vlerësues të jashtëm të programit, konstatuam se Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ka ngritur mekanizma të qartë dhe funksionale për përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Organizimi i Panairit të Punës dhe Aftësive “Work&Study” dhe aktivitetet ndërkombëtare, si “Java e Europës në Universitetin e Tiranës”, mundësojnë përfshirjen e alumnit, studentëve dhe institucioneve publike e private, duke siguruar input të vlefshëm mbi përmbajtjen e programeve dhe lidhjen e tyre me tregun e punës. Ky sistem përfshirjeje është i strukturuar, transparent dhe gjithëpërfshirës, duke garantuar që rekomandimet dhe ekspertiza e jashtme të integrohen në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë



	akademike dhe promovimin e performancës së lartë të stafit dhe studentëve. <i>Evidenca 6.5 – Dokument mbi organizimin e Panairit të Punës dhe Aftësive “Work&Study” në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 6.6 – Raport mbi aktivitetin ndërkombëtar “Java e Europës në Universitetin e Tiranës” dhe përfshirjen e institucioneve publike e private</i> <i>Evidenca 2.29 – Raport mbi bashkëpunimet me aktorë të jashtëm dhe ekspertë në procesin e vlerësimit të programeve të studimit</i> <i>Evidenca 5.24 – Raport mbi pjesëmarrjen e alumnit dhe institucioneve partnere në proceset e përmirësimit të cilësisë së programeve</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ngritur një sistem të qartë, transparent dhe gjithëpërfshirës për përfshirjen e njësive akademike, personelit akademik dhe studentëve në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC) të programeve të studimit. Proceset ciklike të vlerësimit garantojnë monitorim të vazhdueshëm, respektimin e integritetit akademik dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar që të gjithë aktorët e brendshëm të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë.</i> <i>Për më tepër, rezultatat e vlerësimeve dhe masat e ndërmarra publikohen dhe komunikohet në mënyrë transparente të palët e interesuara, duke promovuar një qasje të qëndrueshme ndaj menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Ky sistem integron inputin e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë studentët, alumni-t dhe ekspertët, dhe mbështet arritjen e performancës së lartë akademike dhe formimin e kompetencave të synuara tek studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të	Në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT/FSHN siguron që politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit të jenë transparente

Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	dhe të aksesueshme për studentët dhe aktorët e tjerë të interesuar. Këto informacione publikohen në faqen zyrtare të universitetit/fakultetit, duke përfshirë: Analizat e pyetësorëve, Statutin e UT, Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, si dhe aktivitetet për përmirësimin e cilësisë. Përveç publikimeve online, informacioni shpërndahet edhe përmes shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Bazë, duke siguruar kështu një institucion të hapur dhe gjithëpërfshirës, ku aktorët e brendshëm dhe të jashtëm mund të informohen dhe të përfshihen aktivisht në proceset e menaxhimit dhe vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti i Tiranës/FSHN publikon në mënyrë të qartë dhe transparente rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale (Ligji Nr. 9887/2008, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012). Raportet përfshijnë analizat e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe vetëvlerësimin e lëndëve nga pedagogët, duke siguruar një pasqyrë të qartë dhe të përdorshme për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Ky mekanizëm demonstroi një qasje të standardizuar, transparente dhe të besueshme për publikimin e rezultateve dhe promovimin e integritetit akademik.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Universiteti i Tiranës/FSHN, përmes Departamentit të Bioteknologjisë, ka shoqëruar rezultatet e vlerësimeve të pyetësorëve me një plan masash konkret. Ky plan adreson dhe synon përmirësimin e dobësive dhe mangësive të evidentuara, duke siguruar që informacioni i mbledhur të përdoret në mënyrë efektive për përmirësimin e programeve të studimit. Dokumentacioni i dorëzuar tregon një qasje të strukturuar, sistematike dhe të orientuar drejt rezultateve për rritjen e cilësisë akademike. <i>Evidenca 6.6 – Plan Masash për përmirësimin e cilësisë akademike, bazuar në rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit të studentëve dhe stafit akademik</i> <i>Evidenca 6.7 – Raport mbi zbatimin e Planit të Masave dhe monitorimin e progresit në përmirësimin e programeve të studimit në FSHN, UT</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Universiteti i Tiranës ka vendosur mekanizma efektivë për vlerësimin e veprimtarive të monitorimit të cilësisë dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e programeve të studimit. Plani i Masave i




veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Departamentit të Bioteknologjisë përfshin përmirësimin e pajisjeve laboratorike, forcimin e bashkëpunimit me biznesin dhe industrinë për praktikën profesionale, rishikimin e orëve laboratorike dhe zgjerimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare. Ky mekanizëm tregon një qasje të strukturuar dhe të efektshme për të garantuar cilësi të lartë të mësimdhënies dhe rezultate konkrete në zhvillimin e programeve të studimit. <i>Evidenca 6.7 – Plan Masash i Departamentit të Bioteknologjisë për përmirësimin e programeve të studimit, që përfshin përmirësimin e infrastrukturës laboratorike, zgjerimin e bashkëpunimeve me industrinë dhe rishikimin e strukturës së orëve laboratorike</i> <i>Evidenca 6.8 – Raport mbi zbatimin dhe ndikimin e Planit të Masave në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe në zhvillimin e kapaciteteve akademike në FSHN, UT</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përmes Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, organizon rregullisht aktivitete dhe leksione informuese për personelin akademik dhe studentët, në bashkëpunim me Këshillin Studentor. Këto iniciativa kontribuojnë në ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që marrin në institucion. Gjithashtu, Departamenti i Bioteknologjisë ka hartuar plane konkrete masash për përmirësimin e programeve, duke adresuar dobësitë e evidentuara në rezultatet e vlerësimeve periodike. Këto masa përfshijnë shtimin e pajisjeve laboratorike, forcimin e lidhjeve me biznesin dhe industrinë për zhvillimin e praktikave profesionale, rishikimin e orëve laboratorike të lëndëve me karakter praktik dhe shtimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare. Ky sistem i integruar garanton efektivitetin dhe ndikim të matshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke përfshirë aktivisht studentët dhe personelin akademik në proces. <i>Evidenca 6.7 – Plan Masash i Departamentit të Bioteknologjisë për përmirësimin e programeve të studimit, bazuar në rezultatet e vlerësimeve periodike</i> <i>Evidenca 6.8 – Raport mbi zbatimin e Planit të Masave dhe ndikimin në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit</i> <i>Evidenca 6.9 – Dokumentacion mbi aktivitetet dhe leksionet informuese të organizuara nga DSBCK dhe Këshilli Studentor për</i>

	<i>ndërgjegjësimin e studentëve dhe personelit akademik mbi sigurimin e cilësisë</i>			
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës vlerësuese u konstatua se Universiteti i Tiranës/FSHN ka një sistem të funksional dhe të integruar të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është publik, transparent dhe efektiv. Politikat, procedurat dhe rezultatet e vlerësimeve janë të aksesueshme për studentët dhe aktorët e tjerë të interesuar, ndërsa planet konkrete të masave adresojnë dobësitë e evidentuara dhe përmirësojnë vazhdimisht programet e studimit. Veprimtaritë periodike me studentët dhe personelin akademik nxisin ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive, duke krijuar një Kulturë të Brendshme të Cilësisë dhe duke siguruar efektivitet të matshëm në zhvillimin dhe performancën akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” në “Departamentin e Bioteknologjisë, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë: Universiteti i Tiranës.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi ka një bazë të fortë akademike dhe staf të kualifikuar, me eksperiencë të gjatë dhe përfshirje aktive në kërkime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, gjë që rrit cilësinë e mësimdhënies dhe mbështet zhvillimin profesional të studentëve.
2. Struktura e programit është e balancuar midis teorisë dhe praktikës, duke ofruar një kombinim të lëndëve themelore shkencore me praktika laboratorike dhe profesionale, të cilat zhvillojnë kompetenca të nevojshme për tregun e punës.
3. Programi ka marrëveshje të gjera bashkëpunimi ndërkombëtar dhe kombëtar, si pjesëmarrja në projekte Erasmus+ dhe në aktivitete kërkimore, që rrisin mundësitë për mobilitet të stafit dhe studentëve dhe e forcojnë ndërkombëtarizimin.

Pika të dobëta

1. Mungesa e një mekanizmi të formalizuar për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve dhe formimin e vazhdueshëm profesional pas diplomimit, që kufizon përdorimin e feedback-ut nga alumni dhe punëdhënësit për përmirësimin e programit (*Standardi III.5, Kriteri 7*)
2. Mungesa e një sistemi të integruar për mbledhjen dhe analizimin e feedback-ut nga punëdhënësit dhe ish-studentët e bën të vështirë përmirësimin periodik të kurrikulës sipas nevojave reale të tregut të punës. (*Standardi II.3, Kriteri 5*)
3. Partneritetet me sektorin privat, veçanërisht në bioteknologjinë industriale dhe farmaceutike, janë të kufizuara, çka redukton mundësinë e ofrimit të praktikave profesionale të gjera dhe të zhvillimit të kërkimeve të aplikuara (*Standardi IV.4, Kriteri 6*)

Rekomandime

1. Të krijohet një mekanizëm i qëndrueshëm dhe i formalizuar për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve dhe integrimin e feedback-ut të tyre në zhvillimin e kurrikulës. Ky mekanizëm duhet të përfshijë grumbullimin sistematik të të dhënave mbi punësueshmërinë, suksesin profesional dhe vazhdimin e studimeve të të diplomuarve, si dhe ndërtimin e kanaleve të rregullta komunikimi me alumni. Rezultatet e këtij monitorimi duhet të përdoren si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit.
2. Të forcohen marrëdhëniet me industrinë vendore dhe ndërkombëtare për rritjen e numrit dhe cilësisë së praktikave profesionale. Institucioni duhet të zgjerojë partneritetet me



kompani dhe organizata në fushat e bioteknologjisë industriale, farmaceutike dhe mjedisore, duke përfshirë edhe aktorë të rinj në treg. Këto bashkëpunime do të rrisin mundësitë për praktika të kualifikuara, projekte të përbashkëta kërkimore dhe mundësi punësimi për studentët pas diplomimit.

3. Të promovohet më tej ndërkombëtarizimi i programit përmes programeve të përbashkëta dhe zgjerimit të mobilitetit të stafit dhe studentëve. Kjo mund të arrihet duke zhvilluar programe të përbashkëta (joint degrees, double degrees) me universitete partnere, duke zgjeruar pjesëmarrjen në projekte Erasmus+ dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare, si dhe duke rritur numrin e marrëveshjeve dypalëshe që ofrojnë mobilitet akademik. Një ndërkombëtarizim më i gjerë do të rrisë konkurrueshmërinë dhe reputacionin e programit.


Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Molecular and Industrial Biotechnology" at the Department of Biotechnology, provided by the Higher Education Institution: University of Tirana.

Strengths and affirmations

1. The program has a strong academic foundation and a qualified staff with extensive experience and active involvement in national and international scientific research, which enhances the quality of teaching and supports the professional development of students.
2. The structure of the program is well balanced between theory and practice, offering a combination of core scientific courses with laboratory and professional training, which develop the competencies required in the labor market.
3. The program has broad national and international cooperation agreements, including participation in Erasmus+ projects and research activities, which increase mobility opportunities for staff and students and strengthen the internationalization of the program.

Weaknesses


1. The absence of a formalized mechanism for tracking graduates' career paths and ensuring continuous professional development after graduation limits the systematic use of feedback from alumni and employers for the improvement of the study program. (Standard II.5, Criterion 7)



2. The lack of an integrated system for collecting and analyzing feedback from employers and alumni hinders the periodic improvement of the curriculum according to the real needs of the labor market. **(Standard II.3, Criterion 5)**
3. Partnerships with the private sector, particularly in industrial and pharmaceutical biotechnology, remain limited, reducing opportunities for extensive professional internships and the development of applied research. **(Standard IV.4, Criterion 6)**

Recommendation

1. Establish a sustainable and formalized mechanism for monitoring graduates' career paths and integrating their feedback into curriculum development. This mechanism should include the systematic collection of data on employability, professional success, and further studies of graduates, as well as the creation of regular communication channels with alumni. The results of this monitoring should be used as a basis for the continuous improvement of the program.
2. Strengthen relations with local and international industry to increase both the number and the quality of professional internships. The institution should expand partnerships with companies and organizations in the fields of industrial, pharmaceutical, and environmental biotechnology, including new actors in the labor market. These collaborations would increase opportunities for qualified internships, joint research projects, and potential employment for graduates.
3. Further promote the internationalization of the program through joint degrees and expanded mobility opportunities for staff and students. This can be achieved by developing joint or double degree programs with partner universities, expanding participation in Erasmus+ and other international initiatives, and increasing the number of bilateral agreements that provide academic mobility. A broader internationalization would strengthen the competitiveness and reputation of the program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

